

M.Sc. Safete Statovci - Shala
SHKAQET E HUMBJES SË INTERESIMIT
TË NXËNËSVE PËR MËSIM

Raport hulumtimi

Prishtinë, 2014

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

M.Sc. Ismet Potera

Recensentë:

Prof. asoc. dr. Naser Zabeli

Prof. dr. Demë Hoti

Hulumtuese: M.Sc. Safete Statovci-Shala dhe ekipi i IPK-

Hulumtues të jashtëm:

Prof. Violeta Pirraku-Bajraktari

Mr. Nazyktere Hasani

Lektor:

Arif Demolli

Realizimi kompjuterik:

Skender Mekolli

Ballina:

Benart Shala

Përmbajtja

Abstrakt.....	5
I. Hyrje.....	7
II. Metodologjia.....	9
2.1. Qëllimi i hulumtimit.....	10
2.2. Objektivat.....	10
2.2.1. Objektivat e përgjithshëm.....	10
2.2.2. Objektivat specifike.....	10
2.3. Dizajni i hulumtimit.....	11
2.4. Popullata dhe mostra.....	12
2.5. Instrumentet.....	13
2.6. Procedura e mbledhjes së të dhënave.....	13
III. Procedura e analizimit të të dhënave.....	14
3.1. Shkaqet brendashkolllore dhe jashtëskolllore.....	14
3.1.1. Mësimdhënia joatraktive.....	17
3.1.2. Jokorrektësia ndaj kërkesave të nxënësve.....	20
3.1.3. Mbingarkesat e planeve dhe programeve mësimore.....	21
3.1.4. Disiplina dhe rreptësia e tepërt në shkollë.....	22
3.2. Papërshtatshmëria e mjediseve shkollore.....	25

3.3. Presioni nga nxënësit problematikë në shkollë.....	25
3.3.1. Shkaqet jashtëshkollore.....	26
3.3.2. Gjendja socio-ekonomike në familje.....	27
3.3.3. Gjendja shëndetësore dhe psiko-fizike e nxënësve.....	29
3.4. Rrethanat e përgjithshme shoqërore në arsim.....	29
3.4.1. Paperspektiva ekonomike në vend.....	30
3.4.2. Shkaqe të tjera që ndikojnë në humbjen e rëndësisë së mësimin nga nxënësit.....	30
3.4.3. Kultura e komunikimit mes psikologut, nxënësve e prindërve.....	33
3.4.4. Komunikimi mes shkollës dhe bartësve të aktiviteteve të lira në shkollë motivojnë nxënësit për mësim.....	35
IV. Rezultatet e hulumtimit.....	37
Pyetjet për mësimdhënës.....	37
4.1. Opinionet e mësimdhënësve dhe të nxënësve nga punëtorja.....	48
Pyetjet për nxënës.....	55
V. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	69
5.1. Konkluzionet.....	69
5. 2. Rekomandimet.....	72
Referencat.....	73
Abstract english.....	79

Abstrakt

Derisa arsimimi i shoqërisë është segmenti më i rëndësishëm i çdo vendi, mbetet detyrë e përhershme e institucioneve kompetente që t'i thellojnë hulumtimet rreth dukurive të ndryshme që e shoqërojnë sistemin arsimor në vend. Në këtë kontekst, edhe hulumtimi në vazhdim mëton t'i identifikojë shkaqet kryesore dhe më me peshë që ndikojnë në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, në mënyrë që të ndikohet në ndryshime pozitive në këtë aspekt. Kështu që nga vëzhgimet, bisedat dhe anketat e ndryshme të bëra në disa shkolla të vendit janë identifikuar, ndër të tjera, shkaqe të natyrës subjektive a brendashkolllore, që mund të jenë rezultat edhe i shtrëngesave objektive, dhe të tilla jashtëshkolllore, të cilat janë të kushtëzuara nga rrethana a nga shkaqe të ndryshme, të niveleve të tjera, edhe politike a shoqërore, por gjithsesi jashtë mundësive të ndikimit brenda shkollës. Ndërkaq përhapja e internetit dhe përmasat e pakontrolluara të përdorimit të tij nga të rinjtë, e veçanërisht nga nxënësit, është bërë shqetësim më vete, shumë serioz, të cilit duhet qasur më me seriozitet se deri tash edhe institucionalisht, në mënyrë që të paktën pasojat nga kjo të jenë sa më të pakta a të reduktuara.

Fjalët kyçe: *Shkaqe, vështirësi, jokorrektësi, perspektivë, internet*

I. Hyrje

T'i hysh hulumtimit të shkaqeve të humbjes së interesimit të nxënësve për mësim në rrethanat aktuale, do të thotë të gjendesh para dilemave dhe vështirësive të shumta, sepse ballafaqohesh me shkaqe nga ato objektive, deri tek ato më abstraktet dhe më të paarsyeshmet, sa të mos mund t'i marrësh me mend. Nga njëra anë vëren se ka një interesim në rritje, ose së paku të konsoliduar të një strukture nxënësish për të mësuar dhe për ta thelluar dijen e tyre në çdo nivel dhe, nga ana tjetër, çuditërisht, te një numër i madh dhe, bile nuk është e guximshme të pohohet, sado e dhembshme të jetë, hetohet dukshëm një neglizhim i procesit mësimor, një zbehje e interesimit për të mësuar, një ikje nga angazhimet në mësim me shumë lehtësi. Nëse për këtë kategori nxënësish mund të gjenden arsyeshmëri në përparimet marramendëse të teknologjisë informative dhe, rrjedhimisht, përqendrimin e tepërt dhe të pakontrolluar të tyre në këto mjete komunikimi, siç është interneti dhe së fundi telefonat mobilë, megjithatë si duhet kuptuar kategorinë tjetër, atë që megjithëse kanë qasje në këto mjete komunikimi, nuk e lënë pasdore mësimin dhe angazhimin në përvetësimin e dijeve të parapara me planet dhe me programet mësimore të të gjitha niveleve. Këto shkaqe dhe, natyrisht, të tjera do t'i hulumtojmë në këtë punim, duke u munduar sado pak të kontribuojmë në zbulimin e shkaqeve të vërteta të humbjes së interesimit të nxënësve për mësim dhe të sjellim rekomandime se si ta pengojmë një pritje të tillë.

Realizimi i këtij hulumtimi është arritur me zbatimin e disa metodave hulumtuese që i janë përshtatur natyrës së këtij punimi, ngase duke qenë kryesisht i natyrës teorike, metodat përshkruese dhe ajo analitike më kanë shërbyer si bazë e punës gjatë hartimit të kësaj teme. Edhe vrojtimi i drejtpërdrejtë i aspektit të komunikimit gjatë kontakteve të mia të shumta me organe të ndryshme nëpër shkolla, duke realizuar anketime të ndryshme gojore në funksion të përplotësimit të disa temave hulumtuese të natyrës shkollore, më ka ndihmuar që të nxjerr përfundime mjaft relevante, me shkallë të lartë të vlefshmërisë, rreth cilësisë së komunikimit në shkollat tona. Edhe intervistimi i kategorive të ndryshme në shkolla, që nga organet drejtuese, mësimmthënësit dhe nxënësit e prindërit e tyre, për cilësinë e komunikimit në mes të këtyre faktorëve nëpër shkolla, nxjerr në shesh defekte dhe mangësi të shumta në kulturën e komunikimit nëpër shkollat tona, si një fakt shqetësues për organet kompetente dhe për realitetin tonë arsimor në përgjithësi.

Kultura e komunikimit në mes të familjes dhe shkollës është akti më i rëndësishëm për individin dhe mënyrën se si ai i ndërton marrëdhëniet me të tjerët nëpërmjet këtij procesi. Komunikimi konsiderohet një akt ndërpersonal mjaft i larmishëm, me mundësi të pakufizuara të manifestimit të shkathtësive folëse dhe interpretuese, duke bërë që raportet me të tjerët, qofshin personale a institucionale, të ndërtohen në mënyrë sa më të përkryer, të pëlqyeshme dhe të pranueshme nga palët.

Së këndejmi, edhe komunikimi në institucione arsimore, konkretisht në shkolla, ka peshë jashtëzakonisht të madhe, sepse nga kultura e këtij komunikimi varet drejtpërdrejt performanca e përgjithshme e punës në shkollë. Nuk mund të priten rezultate të dukshme në mësimmthënie e as në mësimmnxënie pa një kulturë të

mirëfilltë, funksionale dhe të suksesshme komunikuese të të gjitha subjekteve në shkollë. Tek e fundit, varet nga vlerat e komunikimit se në ç'nivel do të jenë raportet, se ç'marrëdhënie do të ndërtohen në mes të organeve drejtuese të shkollës dhe komunitetit, mes mësimdhënësve dhe nxënësve si dhe mes personelit shkollor dhe prindërve. Me një fjalë, një komunikim i kulturuar, funksional dhe bindës ka vlerë dhe është parakusht për motivim të të gjithë faktorëve relevantë që kanë të bëjnë me shkollën për t'u mobilizuar për arritjen e rezultateve sa më të mira në shkollë dhe për ngjalljen e interesimit të nxënësve për mësim.

Një rol shumë të rëndësishëm dhe parësor për interesimin e nxënësve për mësim e luan edhe familja, e cila mund dhe duhet të jetë më bashkëpunuese me udhëheqjen e shkollës dhe me mësimdhënësit.

II. Metodologjia e hulumtimit

Për realizimin e këtij hulumtimi janë përdorur metoda të ndryshme, të kombinuara, deskriptive. Po ashtu hulumtimi është mbështetur në metodologjinë kuantitative dhe kualitative ku gjithsesi ato që kanë mundur më lehtë arritjen e qëllime të parapara, siç janë bashkëbisedimet e drejtpërdrejta me drejtorë shkollash, me mësimdhënës dhe me nxënës të kategorive të ndryshme. Nga të gjitha këto kontakte janë nxjerrë konstatime konkrete, pastaj janë realizuar sondazhe, përkatësisht intervista të drejtpërdrejta, gjithashtu edhe gojore, por të parapërgatitura, për të bërë pastaj analiza dhe konstatime përfundimtare për shkaqet e humbjes së interesimit për mësim nga nxënës kategorish të ndryshme. Natyrisht se njohuritë teorike rreth këtyre çështjeve janë plotësuar edhe nga njohuritë empirike, pastaj nga

burime autoritare, për të ardhur te një konkluzion sa më racional rreth çështjeve të shqyrtuara.

2.1. Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka si qëllim parësor t'i zbulojë dhe t'i identifikojë shkaqet dhe motivet e tjera, të çfarëdo natyre qofshin, të cilat ndikojnë në zbehjen apo humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, në mënyrë që institucionet kompetente ta kenë më lehtë të marrin masat e duhura për t'i amortizuar apo mundësisht për t'i eliminuar këto shkaqe, në mënyrë që të bjerë shkalla e nxënësve që tregojnë shenja mosinteresi për mësim, si një prej kërkesave dhe objektivave thelbësorë të institucioneve arsimore në vend.

2.2. Objektivat e hulumtimit

2.2.1. Objektivat e përgjithshëm

Një nga objektivat e përgjithshëm të këtij hulumtimi është nxjerrja në dritë e shkaqeve të të gjitha natyrave, që në çfarëdo mënyre ndikojnë në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, në humbjen e interesimit për t'i ndjekur orët mësimore në shkollë, si dhe në zbulimin e arsyeve të tjera jashtëshkollore që e kushtëzojnë një dukuri të tillë në shkollat tona aktualisht.

2.2.2. Objektivat specifikë:

Ndërsa nga objektivat specifikë nëpërmes këtij hulumtimi do të mundohemi t'i identifikojmë saktë shkaqet që ndikojnë në këtë dukuri, qofshin ato brendashkollore, qofshin jashtëshkollore, të natyrave konkrete. Kjo ngase shkaqet e humbjes së inte-

resimit të nxënësve për mësim janë të ndryshme, andaj në punimin në vazhdim do t'i nxjerrim në pah të gjitha këto shkaqe, duke dhënë edhe rekomandimet konkrete për ta zbutur këtë problematikë në rrethanat aktuale.

2.3. Dizajni i hulumtimit

Hulumtimi është kryer në shtatë rajone të Kosovës, të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, responentë kanë qenë mësimsdhënës dhe nxënës të klasave të teta, të nënta dhe të dhjeta e të njëmbëdhjeta.

Instrumente për mbledhjen e të dhënave kemi marrë pyetësorët për mësimsdhënës dhe nxënës.

Analiza e të dhënave është bërë me programin SPSS.

Objektiv primar çdo shoqëri ka edukimin, arsimimin dhe emancipimin e brezave të rinj, ngase vetëm nga këto veprimtari shoqëria matet, gjykohet dhe vlerësohet se e çfarë niveli është, sa vlen dhe cilat janë potencialet e saj reale për të mirën e përgjithshme dhe progresin e shoqërisë njerëzore në një periudhë kohore të caktuar. Duke u nisur nga ky fakt tashmë të ditur botërisht, edhe shoqëria jonë po bën përpjekje që sistemin e saj arsimor në të gjitha nivelet ta përshtatë për atë që është e mundur me prirjet bashkëkohore, sado që në këtë rrugë po e shoqërojnë edhe telashe, pengesa e vështirësi të ndryshme, si të natyrës objektive, po ashtu edhe të natyrës subjektive. Në këtë kontekst, organet arsimore kompetente të vendit tonë janë në kërkim të një modeli sa më të avancuar të mësimsdhënies dhe të mësimsnxënies, si një parakusht i rëndësishëm për një shkollë të mirë, për një arsimim cilësor dhe për një shoqëri të arsimuar e të edukuar. Mirëpo jo gjithmonë arrihen rezultatet e dëshiruara dhe në rrugë e sipër

shfaqen pengesa të natyrave të ndryshme, të cilat pamundësojnë arrijten e rezultateve të kërkuara apo të synuara. Edhe me anë të këtij hulumtimi janë bërë përpjekje të përcaktohen shkaqet e këtyre vështirësive në procesin e arsimimit të gjeneratave të reja, përkatësisht të diagnostikohet tërë realiteti ekzistues në shkollat tona, në mënyrë që pastaj të merren masa të nevojshme për eliminimin e dobësive, të të metave apo të lëshimeve qofshin ato profesionale, pra brendashkollore, qofshin të natyrës jashtëshkollore, objektive dhe sociale.

2.4. Popullata dhe mostra

Popullata e këtij hulumtimi përfshin të gjitha shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Kosovë, do të thotë në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Popullacioni i këtij hulumtimi është numerikisht i caktuar, i përbërë prej mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, të klasave të teta, të nënta, të dhjeta dhe të njëmbëdhjeta.

Tabela: Struktura e mostrës së hulumtimit

Nr	Komuna	Nxënës		Mësimdhënës		Gjithsej
		F	M	F	M	
1	Mitrovicë	27	24	9	16	76
2	Prishtinë	29	20	13	18	80
3	Gjilan	23	14	12	14	63
4	Ferizaj	28	16	12	7	63
5	Prizren	24	8	9	15	56
6	Gjakovë	23	19	16	9	67
7	Pejë	21	17	11	15	64
Gjithsej		175	118	82	94	469

Siç shihet nga tabela, mostrën e përzgjedhur për hulumtim e përbëjnë, gjithsej 469 respondentë, prej tyre kanë qenë 293 nxënës dhe 176 mësimdhënës dhe nxënës. Mostra ka qenë grupore dhe individuale.

Mostrën e përbëjnë 14 shkolla të komunave Mitrovicë, Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Prizren dhe Pejë.

2. 5. Instrumentet

Përgatitja e instrumenteve për hulumtim në terren ka një rol shumë të rëndësishëm për realizimin e një hulumtimi të suksesshëm.

Për këtë hulumtim janë përdorur pyetësor për nxënës dhe për mësimdhënës dhe është mbajtur një punëtori me nxënës dhe mësimdhënës të klasave të teta, të dhjeta dhe të njëmbëdhjeta në disa komunave të Kosovës.

2. 6. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Gjatë realizimit të këtij hulumtimi të dhënat janë mbledhur në shtatë rajone të Kosovës. Fillimisht leja është marrë nga DKA-të, pastaj nga drejtorët e shkollave ku është kryer hulumtimi.

Janë përfshirë nxënësit e klasave të teta, të nënta, të dhjeta e të njëmbëdhjeta, si dhe mësimdhënësit e lëndëve të ndryshme. Nga punëtorja kanë dalë mjaft sugjerime të arsyeshme për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe mësimdhënësit;

- Nga puna në grupe, nga një grup i përbërë nga mësimdhënësit dhe nxënësit del në pah se familja është faktor kyç për humbjen e interesimit të nxënësve për nxënie dhe anasjelltas.
- Shkarkimi i planeve dhe i programeve të reja nga përmbytjet e vjetruara, nga historicizmi i tepruar dhe nga forma e modele jo në përputhje me metodologjitë bashkohore interpretuese është detyrë e ngutshme dhe nga më të rëndësishmet në sistemin tonë arsimor.

III. Procedura e analizimit të të dhënave

Përpunimi i të dhënave është realizuar sipas metodës së analizës te pyetjet e hapura, deskriptive dhe diferenciale, të dhënat janë analizuar përmes programit kompjuterik SPSS-16 (Statistikore Package for the social Science- Pakoja Statistikore për Shkencat Shoqërore), ku është bërë kodimi i pyetësorëve nga mësimdhënësit dhe nxënësit dhe të dhënat janë futur në programin kompjuterik SPSS.

3.1. Shkaqet brendashkollore dhe jashtëskollore

Pra, nga ajo që kemi arritur të hulumtojmë në këtë aspekt, shkaqet që ndikojnë në humbjen e motivit të nxënësve për mësim mund t'i grupojmë në:

- shkaqet brendashkollore dhe
- shkaqet jashtëskollore (shoqërore).

Synimet e aktiviteteve të përgjithshme të shkollës janë që njeriun e ri, ende të paformuar fizikisht dhe psikikisht ta ndërtojë sipas të gjitha parametrave të përcaktuar, duke filluar nga dijet e parapara me planet dhe programet shkollore e deri të aktivitetet e tjera me karakter ndihmës a plotësues në këtë aspekt.

Pra, me këtë kuptojmë aktivitete shkollore të qëllimshme edukative e arsimore, të cilat realizohen brenda shkollës, nga mësime dhe personeli tjetër i shkollës, si pedagogu e psikologu, të cilët të koordinuar duhet të bëjnë më të mirën e mundshme për një proces të suksesshëm mësimor në shkollë.

Në mënyrë mjaft argumentuese punën brenda shkollës e shohim edhe te Majk Fullan, Siç shihet në tabelën në vijim: Natyra e bashkësive profesionale të nxënies (e përshtatur nga Njomen dhe Ueligj, 1995 dhe Luiz dhe Kruse, 1995).

„Në thelb, argumenti i tyre për punën e brendshme të shkollave të suksesshme qëndron në ndikimin e bashkësive profesionale, sepse sipas tyre:

- Mësime dhe mësuesit mëtojnë një qëllim të qartë për nxënien e të gjithë nxënësve.
- Mësime dhe mësuesit angazhohen në aktivitete bashkëpunuese për të arritur qëllimin.
- Mësime dhe mësuesit marrin përgjegjësi bashkëpunuese për nxënien nxënësve”¹.

¹ Fullan Majkëll, Forcat e ndryshimit, botuar në Prishtinë 1999 , faqe 38 Prishtinë

Vlerësimi i nxënësve
Bashkësia profesionale e nxënies
Praktika pedagogjike

Mirëpo, me gjithë këto përpjekje, me gjithë përmirësimin e dukshëm të praktikave pedagogjike shkollore dhe kurrikulat e reja, ende vërehen, bile në shkallë shqetësuese, dukuri negative që e shoqërojnë aktivitetet në shkollë, duke u shfaqur me humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, e si rrjedhojë me rritjen e numrit të orëve të humbura dhe me rënien e nivelit të mësimnxënies, sidomos nga kategori të caktuara nxënësish, në të gjitha nivelet. Prandaj në këtë aspekt kemi mundur t'i identifikojmë disa nga shkaqet që ndikojnë në mospërfundimin e dëshiruar në mësim nga nxënësit, si:

- mësimdhënia joatraktive,
- sjellja jokorrekte ndaj kërkesave të nxënësve,
- mbingarkesat e planeve dhe e programeve mësimore,
- disiplina dhe rreptësia e tepërt në shkollë,
- papërshtatshmëria e mjedisit shkollor dhe
- presioni nga nxënës problematikë dhe të dhunshëm.

3.1.1. Mësimdhënia joatraktive

Një prej kërkesave thelbësore të mësimdhënies bashkëkohore është realizimi i një mësimdhënieje atraktive me nxënës në klasë, si parakusht për motivimin e duhur të nxënësve për mësim. Motivimi jo i mjaftueshëm i nxënësve nga mësimdhënësi ndikon drejtpërdrejt në angazhimin, përkatësisht mosangazhimin e nxënësve për mësim ose, thënë më ndryshe, ndikon dukshëm në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në procesin mësimor në klasë, pra për të qenë aktivë gjatë këtij procesi si dhe për të treguar shenja pasiviteti në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Nga të gjitha konsultimet e bëra si me mësimdhënësit, ashtu edhe me nxënës, por edhe në disa nga përgjigjet e tyre në anketën tonë me shkrim del se faktor kyç, pa dyshim i rëndësishëm kryesor, është përgatitja e mësimdhënësit, performanca e tij profesionale, thellësia e qasjes së tij njohëse ndaj njësive mësimore që i shtjellon me nxënës në klasë, si dhe serioziteti dhe afërsia emotive me të cilën u qaset nxënësve gjatë analizës së njësive mësimore. Kur mësimdhënësi të ketë ndërtuar një autoritet të pakontestueshëm profesional, një qëndrim të formuar etik dhe të dëshmojë përgjegjshmëri profesionale dhe korrektësi ndaj nxënësve, atëherë pa dyshim se arrin edhe realizim të mësimdhënies së suksesshme, derisa mosarritja a mosrealizimi i këtyre kritereve a cilësive ndikon në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në masën e duhur për mësim dhe rrjedhimisht edhe në rënien e cilësisë së mësimnxënies në shkollë.

Duke e ditur faktin se komunikimi është faktor themelor për aplikimin e partneritetit në shkollë, pra si me partnerët e jashtëm, ashtu edhe për palët e tjera të interesuara, që në një

mënyrë apo në një tjetër janë të lidhura me shkollën, atëherë shtrihet çështja e përfshirjes së këtyre faktorëve në jetën e shkollës. Këtë rol e kanë drejtori së bashku me këshillin e shkollës, si organe kompetente, të cilët duhet të përzgjedhin mënyrat sesi t'i realizojnë këta objektiva, duke bërë artikulumin e efektshëm të qëllimeve, kërkesave dhe programeve, pra duke i informuar mësuesit dhe prindërit për strategjitë që duhet zbatuar për krijimin e një klime të favorshme dhe të një kulture të pranueshme jo vetëm komunikuese në përputhje me kërkesat bashkëkohore të shkollës. “Komunikimi në shkollë do të thotë përfshirja e të gjithë akterëve të shkollës në procesin e arritjes së synimeve dhe objektivave të shkollës, kështu që jo vetëm pjesëmarrja, por edhe marrja parasysh e mendimeve të të gjithë akterëve të shkollës në lidhje me vendimet e marra në shkollë”².

Komunikimi transparent, konkret dhe i plotë është çelës për të krijuar këtë partneritet me të gjitha organet e nevojshme, të cilat janë në interes të shkollës dhe të bashkësisë së gjerë. E që komunikimi të realizohet me sukses, gjithsesi duhet paraprakisht të përgatitet plani për komunikimin, në të cilin duhet të merren parasysh shumë aspekte, si formati i komunikimit, personat me të cilët duhet komunikuar, përzgjedhja e strategjive më të përshtatshme për komunikim, afatet kohore dhe subjektet e ngarkuara për komunikim. Gjithsesi duhet pasur parasysh a janë përfshirë në këtë planifikim të gjitha aktivitetet e nevojshme të shkollës, në mënyrë që të mos mbetet e papërfshirë asgjë e rëndësishme që do t'i kontribuonte mbarëvajtjes së punës së përgjithshme të shkollës.

Interesimi i nxënësve për mësim duhet të ketë një komunikim të qëndrueshëm, konstruktiv dhe të rregullt, në

² GIZ-Modul: “Komunikimi dhe bashkëpunimi”, Prishtinë 2012, fq. 7

radhë të parë në mes të vetë organeve të shkollës, e pastaj edhe mes faktorëve të tjerë, në këtë kontekst një komunikim i efektshëm mes mësimitdhënësve dhe nxënësve është parësor dhe thelbësor, duke vazhduar edhe me prindërit e nxënësve, sepse koncepti i një shkolle demokratike dhe bashkëkohore kërkon vënie e të drejtave të fëmijëve në qendër të shkollës. E pjesëmarrja e pamjaftueshme ose joadekuate e prindërve nuk është në interes të shkollës, andaj shkollla duhet të sigurojë instrumentet për pjesëmarrjen e prindërve në jetën e shkollës, të shtojë motivimin institucional dhe të ndërtojë raporte të shëndosha e të efektshme me prindërit, sepse pjesëmarrja e tashme nga vëzhgimet tona që kemi bërë në disa shkollla nuk është e kënaqshme, për më tepër, ka shkollla ku kontakti me prindër është vetëm formal, e si rrjedhojë nuk ndikon në avancimin e punës në shkolle dhe në shtimin e mundësive për fëmijët. Përveç kësaj, organet drejtuese të shkollës e kanë për obligim t'i sigurojnë edhe të drejtat e fëmijëve, të cilat janë të garantuara me ligjet e brendshme dhe me konventat e të drejtave të fëmijëve në nivel të shteteve dhe në atë ndërkombëtar. Prandaj që t'i kontribuohet kësaj subjektet kompetente të shkollës duhet qasur aspektit të komunikimit me nxënës në mënyrë sa më profesionale, duke i pasur parasysh të gjithë faktorët konstituivë të personalitetit të fëmijës në niveleve përkatëse.

Udhëheqja e mirë dhe e ekuilibruar ka rëndësi për një shkolle të suksesshme, sepse kjo reflekton drejtpërdrejt dhe mbi të gjitha në suksesin e përgjithshëm të nxënësve dhe në arritjet dhe rezultatet e kënaqshme të tyre. Andaj kësaj çështjeje i kushtohet rëndësi e dorës së parë, sepse nga mënyra e udhëheqjes së një institucioni, respektivisht të një shkolle varet tërë puna dhe rezultatet e përgjithshme në mësim. Prandaj edhe në teorinë pedagogjike i kushtohet rëndësi e veçantë kësaj çështjeje, duke i

shqyrtuar të gjithë parametrat, kërkesat dhe vlerat që duhet t'i ketë drejtori i një institucioni shkollor, por edhe organet e tjera drejtuese të saj.

Duke e ditur faktin se drejtori, si udhëheqës i institucionit arsimor, ka përgjegjësinë më të madhe në shkollë, duke bartur tërë aktivitetin rreth shkollës në të gjitha nivelet, ai shërben edhe si një koordinator në mes të organeve e stafit të shkollës dhe organeve kompetente komunale, respektivisht Drejtorisë Komunale të Arsimit. Prandaj është e preferuar, apo mund të themi është e domosdoshme që personaliteti i drejtorit të jetë i kompletuar, duke pasur të gjitha parakushtet e një personi udhëheqës, si të jetë komunikativ, bashkëpunues, i gatshëm për t'u ballafaquar me situata stresi e të tjera, i matur dhe objektiv në gjykimet e tij. Kjo ngase, në shumë raste, nga vendimet e tij, edhe nën ndikimin e gjykimeve subjektive, lindin konsekuenca që më shumë a më pak ndikojnë në punën e gjithanshme në shkollë.

Organet e shkollës kanë rëndësinë dhe peshën e pazëvendësueshme në mbarëvajtjen e punëve në shkollë, të cilat vetëm sa e fuqizojnë dhe e bëjnë udhëheqjen e shkollës më efikase, më funksionale dhe më të suksesshme. Prandaj, në këtë punim do të mundohem të shtroj disa karakteristika të veçanta, të cilat nxjerrin në shesh të dhëna interesante, në mos krejt të reja për një menaxhim të suksesshëm të një institucioni shkollor.

3.1.2. Jokorrektësia ndaj kërkesave të nxënësve

Sjellja e mësimdhënësve në shkollë, e veçanërisht në klasë, në raport me nxënësit, ka rëndësi të madhe, ngase qasja e tij ndaj tyre ndikon drejtpërdrejt në motivimin ose jomotivimin e tyre për mësim. Një mësimdhënës emotiv, impulsiv a me qëndrime të ashpra ndaj nxënësve krijon klimë jo të përshtatshme në

klasë, demotivim për mësim dhe neglizhim të nxënësve ndaj procesit mësimor dhe shkollës në përgjithësi. Nxënësit i spikatin këto cilësi të personalitetit të mësimdhënësit dhe kjo ndikon në qëndrimin e tyre ndaj shkollës, prandaj s'ka dyshim se qëndrimi i afërt, i ngrohtë dhe me takt i mësimdhënësve ndikon në afërsinë e nxënësve ndaj shkollës, në krijimin e një klime të favorshme dhe në suksesin e përgjithshëm në mësimnxënie.

3.1.3. Mbingarkesat e planeve dhe programeve mësimore

Sado që planet dhe programet mësimore, për të gjitha nivelet e sistemit arsimor, përgatiten nga ekipe ekspertësh arsimorë, të cilat përfshijnë përmbajtjet mësimore të vlerësuara si më të mirat dhe më të vlefshmet për nivelet përkatëse, si dhe tema të tjera plotësuese në funksion të përplotësimit të planit dhe të programit mësimor si tërësi, është perceptim i shumicës dërrmuese të prindërve dhe të nxënësve se ato janë të mbingarkuara. Dhe ky fakt s'do mend se ndikon negativisht edhe në motivimin e nxënësve për shkollën dhe procesin mësimor, ngase kërkesat e tepërta dhe mosselektimi i duhur i përmbajtjeve mësimore nga mësimdhënësit drejtpërdrejt ndikon edhe në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim.

“Ngarkimi i programeve mësimore me material të tepërt, që është një nga pengesat më të mëdha të realizimit të bazës shkencore në mësim, merr kohë dhe nuk lejon thellimin e diturive, lidhjen e teorisë me praktikën, zhvillimin dhe formimin e drejtë të koncepteve dhe përforcimin e tyre”.³

³ Dr. Nijazi Zylfiu: “Didaktika”, Prishtinë 2001, faqe. 158

3.1.4. Disiplina dhe rreptësia e tepërt në shkollë

Një element tjetër, për humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, në të vërtetë me peshë të madhe në krijimin e një klime të përshtatshme në shkollë, është edhe disiplina e ashpër në mjediset shkollore, përkatësisht kërkesat e shumta dhe të panevojshme në emër të ruajtjes së një rendi në shkollë. Këto kërkesa, si për shembull, mbajtja e rregullt e uniformës a respektimi i kujdestarive të ndryshme nga nxënësit në objektet shkollore, duke mos pasur një ndjeshmëri tolerance, herë-herë rëndojnë klimën e përgjithshme në shkollë, sado që e tërë kjo bëhet në emër të krijimit të një mjedisi sa më të përshtatshëm dhe të një rendi shtëpiak në shkollë. Në këto angazhime organet drejtuese të shkollës duhet të jenë të matura dhe të tregojnë një shkallë tolerance, ngase në të kundërtën arrihen efektet e kundërta me ato të synuara. Konkluzione të tilla dalin nga bisedat si me nxënësit, ashtu edhe me prindërit, të cilët, sado që e mbështesin një rend dhe rregull në shkollë, kanë edhe ankesa konkrete nga teprime të ndryshme të kësaj natyre. E kjo pa dyshim ndikon edhe në (jo)motivimin e nxënësve për procesin e përgjithshëm mësimor në shkollë.

Pjesë thelbësore e punës edukative-arsimore në shkollë është edhe komunikimi i rregullt, i efektshëm dhe funksional në mes të mësimit dhe nxënësit, e veçanërisht me nxënësit që tregojnë ngecje në mësimnxënie dhe me ata që paraqiten më të ndjeshëm në planin emotiv, por edhe me fëmijë problematikë.

“Vështirësitë në shtëpi ose në shkollë, pikëllimi, hidhërimi ose zënkat me moshatarët janë shembuj kur fëmija ka problem.

Fëmija duhet ta ketë dikë që kujdeset për të, e dëgjon dhe bashkëndien me të, për të parë natyrën e ndjenjave të veta dhe për të zgjedhur rrugën më të mirë për zgjidhjen e problemeve”⁴.

Në krejt këtë qasje duhet pasur për bazë idenë e respektimit të dinjitetit të fëmijëve, duke e vënë interesin e tyre si prioritet të pakontestueshëm, e në këtë kontekst edhe respektimin e mendimit të tyre si e drejtë themelore, në mënyrë që t’i mundësohet secilit nxënës t’i shprehë mendimet e veta jo vetëm rreth mësimit, por edhe për çështje të tjera që e mundojnë ose e preokupojnë gjatë kohës sa e vijon shkollimin.

”Mënyra e komunikimit me fëmijët mund të dërgojë porosi të respektit, të empatisë dhe të kujdesit, porse gjithashtu mund të dërgojë edhe porosi të kundërta...Përveç kësaj, komunikimi ynë është një model për fëmijët në komunikimin e tyre me të tjerët...”⁵.

Dhe në këtë punë mësimit nxënësi është faktori i parë që duhet qasur në mënyrë të qetë, me takt, të afërt e me ngrohtësi, duke e bindur secilin nxënës se mendimet, vërejtjet eventuale a sugjerimet e tjera që në çfarëdo mënyre lidhen me shkollën do të merren parasysh. Është ky aspekt i rëndësishëm i ndërtimit të raporteve të mira mësimit - nxënës, si hallkë e domosdoshme për arritjen e rezultateve të dëshirueshme në suksesin e nxënësve dhe në cilësinë e përgjithshme të mësimit, kriteri i domosdoshëm për shkollën moderne. Derisa është pikërisht mësimit ai që ka rol të drejtpërdrejtë, të rëndësishëm gati po aq sa prindi, në ndërtimin e personalitetit të nxënësit, në zhvillimin e tij të përgjithshëm, në kultivimin e vlerave të tij

⁴ Bonnie Miller: “Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit”, QPEA, Prishtinë 2003, faqe, 134

⁵ Bonnie Miller: “Komunikimi me fëmijët”, QPEA, Prishtinë, 2004, faqe, 18.

shoqërore, si tolerancës, bashkëpunimit, vetëpërgjegjësisë etj. Një komunikim intelektual dhe kreativ është i domosdoshëm edhe në procesin e mësimdhënies apo të vlerësimit të njohurive të nxënësve. “Procesi i komunikimit në shkollën moderne vazhdon, sepse duke punuar pavarësisht me materie të re, nxënësi i ofron mësimdhënësit mundësinë që të shohë se si e ka kuptuar materien e re, që pastaj mësimdhënësi ta informojë nxënësin për rezultatin e mësimin të tij”⁶.

Nga gjithë kjo sa u tha mund të konstatojmë se mësimdhënësi me qasjen e tij aktive, veç zhvillimit të procesit mësimor, me anën e një komunikimi funksional, me qasje profesionale dhe të autoritetshme, do të ishte e preferueshme që gjithmonë të konsultohet me psikologun, nëse tashmë ky shërbim funksionon në shkollë, të identifikojë gjendjen psiko-fizike të nxënësve me ngecje të veçanta, t’i inkurajojë ata për të vazhduar me ngulm për arritje më të mira, t’i zbulojë veçantitë dhe prirjet e nxënësve me aftësi mesatare, që t’i trajtojë ata në mënyrë të veçantë, pastaj t’i aktivizojë maksimalisht potencialet intelektuale të nxënësve të dalluar drejt një perspektive me të avancuar arsimore, në mënyrë që talentet e dalluara të përgatiten për ecjen e tyre të sigurt në karrierën e tyre shkollore e profesionale në të ardhmen.

S’ka dyshim se mësimdhënësi është në rolin e ndërmjetësuesit në mes të shkollës, prindërve dhe shoqërisë së gjerë, kështu që edhe perceptimet e tij për nivelin e cilësive të nxënësve kanë rëndësi thelbësore për orientimin e tyre profesional e jetësor në të ardhmen, që pa dyshim reflekton edhe në nivelin e përgjithshëm shoqëror të një vendi. Kështu që barrë e mësimdhënësve është që t’i inkurajojnë nxënësit që të shprehin interesimin e tyre dhe të motivohen për angazhim aktiv në

⁶. ETMM...” “Pedagogjia”, Prishtinë 1980, faqe, 403.

marrjen e vendimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën e tyre në shkollë e në rrethin ku jetojnë. Krejt këto qëllime të mësimdhënësve arrihen në radhë të parë me një komunikim të efektshëm, të kulturuar, bindës e civilizues, duke ndërtuar një autoritet profesional të pakontestueshëm jo vetëm te nxënësit, por edhe për komunitetin përreth.

3.2. Papërshtatshmëria e mjediseve shkollore

Një faktor gjithsesi me peshë në procesin e përgjithshëm mësimor është edhe mjedisi shkollor, si ai i brendshëm, po ashtu edhe ai jashtëshkollor. Një mjedis klase i rregulluar mirë, i pastër dhe i pajisur me orendi të domosdoshme, me hapësirat dhe me ndriçimin e duhur, që afron komoditetin e nevojshëm për nxënësit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në motivimin e nxënësve për mësim dhe në klimën e përgjithshme pozitive gjatë procesit mësimor. Po kështu mund të thuhet edhe për mjedise jashtëshkollore: një oborr i rregulluar mirë, me shtigjet për ecje, me ulëset pushuese dhe me gjelbërimin e nevojshëm s'do mend se ndikon në krijimin e një klime të favorshme në shkollë dhe në motivimin e nxënësve për mësim. Ishte vërejtje e përgjithshme se përgjithësisht në shkollat tona mungon një kulturë e krijimit dhe e ruajtjes së mjediseve të përshtatshme rreth shkollave, aspekt që në të ardhmen gjithsesi duhet kushtuar edhe rëndësi më të madhe institucionale.

3.3. Presioni nga nxënësit problematikë në shkollë

Nga të gjitha vrojtimet e bëra dhe format e tjera të kontaktit me nxënësit dhe mësimdhënësit ka dalë se një prej shkaqeve që në një mënyrë ka presion të drejtpërdrejtë në humbjen e

interesimit të fëmijëve për mësim është kontakti i tyre me nxënës problematikë, të cilët sikur kanë aftësi të veçantë që të përvetësojnë fëmijë në rrjetin e tyre të sjelljes e të veprimit të përditshëm. Kjo manifestohet sidomos te një kategori nxënësish me qëndrime të luhatshme, pa një karakter të fortë dhe pa ndonjë mbikëqyrje të veçantë nga prindërit. Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me ta, një fëmijë me temperament të ndjeshëm, që manifeston sjellje agresive, sjellje antisociale, apo angazhim në aktivitete me rrezikshmëri, qoftë edhe të një shkalle jo tepër të lartë, sikur është i prirur që të bashkojë rreth vetes fëmijë të tjerë, ndaj të cilëve do të mundë të ushtrojë jo vetëm presion në veprime të caktuara, por edhe autoritetin e tij, si “lider” i pakontestueshëm dhe si qendra e organizimit të çdo aktiviteti. Prandaj, këta nxënës, apo secilin që në çfarëdo mënyre tregon sjellje të pakontrolluar gjithsesi psikologu duhet t’i bëjë objekt trajtimi gjatë gjithë kohës sa janë në shkollë, ndërsa mësimdhënësit duhet të kenë qasje tjetër, një angazhim të veçantë në raport me ta, ashtu edhe në kërkesat për mësim, në mënyrë që sado pak të ndikojë në riorientimin e tyre, apo së paku në ruajtjen e një “standardi të pranueshëm” të sjelljes së tyre, mundësisht së më të kontrolluar.

3.3.1. Shkaqet jashtëshkollore

S’ka dyshim se edhe faktorë të jashtëm mund të jenë shumë aktivë dhe po aq të dëmshëm që reflektojnë drejtpërdrejt edhe në procesin mësimor, në mjedisin e përgjithshëm në shkollë, duke ndikuar edhe në humbjen e interesimit për mësim. Ndër këta faktorë si më i rëndësishmi në këtë aspekt del të jetë familja, përkatësisht gjendja e saj e përgjithshme, ekonomike dhe niveli i saj arsimor. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në klimën e përgjithshme në familje, e ajo drejtpërdrejt, nëpërmjet

fëmijëve të tyre nxënës, reflekton në shkollë, në atmosferën e përgjithshme të saj dhe në punën e mësimdhënësve, qoftë kolektive a individuale me nxënës, që në mënyrë të ndjeshme ndikon në rezultatet e mësimnxënies dhe të shkollës në përgjithësi.

Kështu, nga shkaqet e jashtme të kësaj natyre mund t'i veçojmë:

- gjendja socio-ekonomike në familje,
- gjendja shëndetësore dhe psiko-fizike e nxënësve,
- rrethanat e përgjithshme shoqërore në arsimin e një vendi dhe
- paperspektiva ekonomike në vend.

3.3.2. Gjendja socio-ekonomike në familje

Struktura e familjes dhe marrëdhëniet brenda saj, sidomos në rrethanat aktuale kur familja tradicionale po pëson probleme të shumta sociale, shpeshherë edhe me pasoja të dëmshme deri edhe shkatërrimtare, reflekton gjithsesi në suksesin e nxënësve në mësim dhe rrjedhimisht edhe në humbjen e interesimit të tyre ndaj shkollës dhe procesit mësimor.

”Pa marrë parasysh trajtimet e ndryshme të këtyre çështjeve lidhur me marrëdhëniet në familje, të gjithë pajtohen që familja ndryshon vazhdimisht, që do të thotë, pra, se me zhvillimin historiko-ekonomik të shoqërisë, janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar edhe funksionet e familjes, marrëdhëniet reciproke ndërmjet prindërve e fëmijëve, posaçërisht pozita e fëmijës në familje”.⁷

Në rrethanat aktuale në realitetin tonë jetësor vërehen shkaqe të ndryshme të cilat ndikojnë në stabilitetin e familjes, të cilat i kemi klasifikuar si:

⁷ Grup autorësh, Pedagogjia, Prishtinë 1988, faqe. 246

- shkaqe subjektive dhe
- shkaqe objektive.

Vërtet në kushtet e demokratizimit të shoqërisë në përgjithësi e të familjes në veçanti hetohen ndjeshëm edhe dukuri të dëmshme, të cilat prekin në thelb vetë familjen, herë-herë edhe funksionimin normal të saj, me pasoja të dëmshme për një shoqëri. Kështu që janë fëmijët ata që goditen më së shumti nga këto raporte, përkatësisht nxënësit, të cilët nuk kanë se si të mos ndikohen nga marrëdhëniet e prindërve të tyre, derisa janë të varur dhe jetojnë në përkujdesën e tyre.

Në të gjitha bisedat e bëra me nxënës dhe mësimitdhënës ky fakt përmendet si më shkatërrimtari për personalitetin e nxënësit, për orientimin e tij në shoqëri dhe, për pasojë, edhe për qëndrimin e tij ndaj shkollës e mësimit në përgjithësi. Te këta fëmijë vërehen sjellje të pakontrolluara, lindja e komplekseve të ndryshme deri edhe te prirjet për prapësi e dukuri të tjera negative, që gjithsesi ndikon në gjendjen e përgjithshme në klasë, në procesin mësimor dhe në shkollë në përgjithësi.

Ndërkaq nga shkaqet objektive është e qartë se statusi ekonomik i familjes ka rëndësi të madhe dhe me peshë për secilin anëtar të saj. Veçanërisht kjo prek edhe fëmijët në shkollë, përkatësisht në qëndrimin e tyre emotiv, të cilët, në shumicën e rasteve, nxënësit me status ekonomik të lartë dallohen për nga individualiteti i tyre i tejdukshëm, i imponueshëm e me synimin për të dalë në plan të parë, herë-herë edhe në mënyrë joparimore, në kundërshtim me kategorinë e nxënësve me status ekonomik më të keq a mesatar. Kjo kategori nxënësish, ndryshe nga të parët, janë më të tërhequr, më të mbyllur në vetvete dhe zakonisht më pasivë në mësim, por që nuk mund të thuhet gjith-

herë kështu, sepse ka edhe raste përjashtuese nga të dy kategoritë.

3.3.3. Gjendja shëndetësore dhe psiko-fizike e nxënësve

Shëndeti i nxënësve pa dyshim se është i rëndësisë thelbësore që kushtëzon motivimin për mësim dhe për arritje në mësimnxënie. Nga vëzhgimet tona dhe nga bisedat me mësimdhënës kemi konstatuar se rastet e nxënësve pa shëndet të mirë e stabil ndikojnë në mirëvajtjen e orës mësimore, përkatësisht krijojnë atmosferë destabilizuese në klasë, ngase ndikojnë në klimën e përgjithshme gjatë procesit mësimor, duke zhvendosur interesimin nga mësimi dhe hapjen e komentimeve të ndryshme rreth shëndetit të nxënësve përkatës.

Edhe rastet e nxënësve me gjendje psiko-fizike jonormale, apo me simptoma të ngjashme të shumtën e herëve krijojnë gjendje jostabile për mësim në klasë apo situata jo të këndshme në shkollë, kështu që domosdoshmërisht ndikojnë në rënien apo humbjen e interesimit të nxënësve për mësim, ose së paku në devijimin nga ecuria normale e një ore mësimore, që reflekton në suksesin e përgjithshëm në mësimnxënie.

3.4. Rrethanat e përgjithshme shoqërore në arsim

Edhe rrethanat e përgjithshme arsimore në vend ndikojnë në gjendjen e secilës shkollë veç e veç, në klimën e përgjithshme të tyre, qoftë në aspektin pozitiv, qoftë në aspektin negativ. Kjo reflektohet në organet drejtuese të shkollave, por edhe në personelin mësimdhënës a atë ndihmës, kështu që në rrethana pakënaqësish të dukshme në nivele qendrore, qoftë si rezultat i politizimeve të imponuara, qoftë si rezultat i kushteve rënduese objekti-

ve, gjithsesi rezultatet në shkolla nuk do të jenë inkurajuese. Dhe s'do mend se në kushte të tilla gjendja në shkolla është e pafavorshme, me implikime edhe në sjelljet e nxënësve dhe në pasivitetin e prindërve, kurse krejt kjo me performancë të dobët të institucioneve shkollore dhe me rezultate dekurajuese në mësimnxënie.

3.4.1. Paperspektiva ekonomike në vend

Aspekti i gjendjes ekonomike është faktori kyç që motivon dhe shtyn mësimdhënësit për angazhime të duhura dhe profesionale në procesin mësimor, është parakusht për rezultate dhe arritje të duhura e në përputhje me kërkesat e standardeve bashkëkohore në mësimdhënie. Niveli ekonomik dhe mirëqenia e përgjithshme e kategorisë arsimore në çdo vend ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në stimulimin e tyre për punë sa më të efektshme në shkolla, por edhe në motivimin e përgjithshëm të shoqërisë, pa dyshim edhe të nxënësve për t'u angazhuar me tërë qenien dhe potencialet e tyre në mësim dhe në thellim dijesh nga lëmenjtë përkatës. Ngase motivimi ekonomik kushtëzon edhe motivimin e nxënësve për rezultate më të mira në shkollë, derisa në të kundërtën është faktor dekurajues dhe shkakton humbjen e interesimit për shkollën dhe sistemin arsimor në përgjithësi.

3.4.2. Shkaqe të tjera që ndikojnë në humbjen e rëndësisë së mësimin nga nxënësit

Kohët e fundit zhvillimi i teknologjisë informative, sidomos i internetit dhe i telefonave mobilë, po ndikon ndjeshëm dhe në shkallë shqetësuese në riorientimin e të rinjve, sidomos të nxënësve, ndaj mësimin. Kjo tashmë nuk mund të quhet dukuri,

sepse ka marrë shtrirje aq gjithëpërfshirëse sa nuk duket e mundshme të ndërhyhet në mënyrë të organizuar nga instanca të ndryshme shoqërore. I mbetet familjes të shtojë përkujdesjen ndaj fëmijëve të saj që së paku përdorimi i internetit të marrë qasje të kontrolluar, ngase shkëputja nga ai tashmë duket e pamundshme dhe, për më shumë, kërkesë absurde. Nga bisedat në familje të shumta janë shfaqur shqetësime nga prindërit, pa përjashtim, se trendët aktualë të përdorimit të internetit çojnë në përmasa të pakontrolluara të qasjes ndaj tij, e kjo pashmangshëm në rënien e interesimit për mësim. Kjo pa dyshim se është argument i fuqishëm që në mënyrë institucionale shoqëria jonë t'i qaset këtij problemi, në mënyrë që ta sensibilizojë rëndësinë e përdorimit të kontrolluar të internetit dhe sidomos në favor të ngritjes profesionale apo të marrjes së selektuar të informacionit të ofruar në të nga të rinjtë dhe nxënësit tanë. Andaj këtij problemi duhet qasur më me seriozitet edhe nga shkolla, me angazhimin edhe të prindërve, por edhe të institucioneve kompetente në nivel vendi.

Natyrisht se në arritjen e një komunikimi sa më të efektshëm, racional dhe të dobishëm në mes të udhëheqjes së shkollës dhe prindërve ka edhe pengesa të ndryshme, nga ato objektive, deri tek ato të natyrës subjektive, të cilat duhet të eliminohen gjithsesi nëse duam rezultate në performancën e shkollës. Mirëpo, duke e njohur realitetin tonë të sotëm, por edhe nga vrojtimet e mia gjatë vizitave në disa shkolla nuk kam vërejtur ndonjë planifikim apo strategji të përpunuar që do të mundësonte të realizohet një komunikim i mirëfilltë në mes të organeve drejtuese të shkollës dhe komunitetit të prindërve, kështu që kjo vijë komunikimi mes tyre realizohet vetëm sipas vullnetit dhe interesimit personal të secilit prind. Këtu për hir të korrektesisë duhet thënë se një planifikim në letër ekziston gati në secilën

shkollë, ku këto kontakte me prindër është menduar të realizohen vetëm me rastin e përfundimit të gjysmëvjetorit të parë dhe në fundvitin shkollor, të cilat kanë vetëm karakter informativ për rezultatin e fëmijëve të tyre. Gjithashtu një aktivizim në komunikimin me prindër vërehet edhe në kohën e organizimit të ekskursioneve me nxënës, apo para ndonjë aksioni ku domosdoshmërisht nevojitet ndihma e prindërve, kjo nëpërmjet Këshillit të prindërve, por praktika ka dëshmuar se numri i prindërve të përfshirë në këto komunikime ka qenë gjithmonë i vogël ose, në variantin më të keq, ajo përfshirje ka qenë krejt simbolike apo edhe selektive.

Ndërsa sipas pikëpamjeve subjektive të organeve të shkollës, arsyet e mosfunksionimit normal të komunikimit mes shkollës e prindërve qëndrojnë:

- te mungesa e interesimit të prindërve të komunikojnë me shkollën;
- te koha e kufizuar e prindërve që të angazhohen për çështjet e shkollës, si dhe
- te mungesa e shkathtësive të komunikimit.⁸

Pra nga të gjitha bisedat me drejtorët e shkollave për mosfunksionimin e një komunikimi më aktiv me prindërit del se pengesë kryesore është mungesa e interesimit të prindërve, pastaj koha e kufizuar e tyre, përkatësisht angazhimet e shumta në punë, të cilat ua pamundësojnë angazhimin edhe në aktivitetet e shkollës, por si çështje u përmend edhe mungesa e shkathtësive të komunikimit nga prindërit, duke mos përjashtuar ndonjë rast të rrallë edhe nga mësimdhënësit. Sado që këto duken arsyetime

⁸ D.Pupovci, N. Tafarshiku, Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë, Prishtinë 2008, faqe. 43

subjektive, edhe pse nuk mund të injorohen në tërësi, kjo nuk lejohej të shërbejë si alibi e mosrealizimit të një komunikimi thelbësor dhe plotësisht funksional mes organeve të shkollës dhe prindërve, sepse me gjithë angazhimet e shumta, prindërit shprehen të gatshëm të kontribuojnë në rezultatet e përgjithshme në shkolla. “Komunikimi i sinqertë dhe i vazhdueshëm në mes të faktorëve relevantë shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunimi e ndërveprimi i tyre mund ta zhvendosë fëmijën/nxënësin nga pozita e objektit në atë të subjektit aktiv”.⁹

Edhe një fakt tjetër që mund të vërehet në shkollat tona, sado që rrallë, është atmosfera e përgjithshme e mospajtimeve dhe e kundërshtimeve të ndryshme, deri edhe konfliktuoze, në mes të shkollës, pra organeve udhëheqëse të saj dhe prindërve, e cila ndikon në humbjen e interesimit të prindërve për të qenë aktivë në komunikimin me shkollën. Këtu hyjnë edhe shkaqe tepër subjektive, por sidoqoftë ato reflektojnë në klimën e përgjithshme në shkollë.

3.4.3. Kultura e komunikimit mes psikologut, nxënësve e prindërve

Në kushte bashkëkohore të jetës prania e psikologut në shkolla pothuajse është bërë e domosdoshme, pikërisht duke e parë nevojën e madhe të funksionimit të këtij shërbimi. Prandaj, në këtë kontekst ndikimi i psikologut në parandalimin e dukurive devijuese apo në zgjidhjen e situatave konfliktuoze në shkolla duhet të jetë i rëndësishëm vendimtar, kështu që lind nevoja e një planifikimi të komunikimit mes këtij shërbimi, nxënësve dhe komunitetit të prindërve. Derisa komunikimi mes psikologut dhe

⁹ Prof. dr. Afërdita Deva –Zuna, Partneriteti shkollë-familje-komunitet, Prishtinë 2009, faqe. 479

nxënësve mund të realizohet në kuadër të kornizave të punës në shkollë, ai me prindër kërkon strategji të përpunuar, duke iu përshtatur edhe rrethanave jashtëshkollore, përkatësisht angazhimeve të prindërve, në mënyrë që ata objektivisht të kenë mundësi të inkuadrohen në aktivitetet e shkollës.

Një prej roleve parësore të psikologut në shkollë është t'i ndërgjegjësojë prindërit në nevojën e domosdoshme për integrimin e tyre në zgjidhjen e çështjeve psiko-sociale, menaxhuese e organizative për fëmijët e tyre dhe kjo jo vetëm të atyre me paraqitje agresive a dhune në raport me shokët, mësimdhënësit apo me të tjerë jashtë shkollës. Dhe sado me profesionalizëm, me durim e me këmbëngulësi t'u qaset psikologu këtyre rasteve për rehabilitimin e tyre, pa ndihmën e prindërve, pa ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë gjasat për arritje të rezultateve të kënaqshme të këta të rinj janë pothuajse të pashpresa. Që të arrijë këtë psikologu duhet të realizojë aktivisht takime me prindër, qoftë individualisht, qoftë në grupe, në mënyrë që t'i bindë ata me domosdoshmërinë e përfshirjes së tyre në angazhime të përbashkëta për përmirësimin e sjelljeve a të shprehive arrogante e të gjykuara si të dëmshme për fëmijët, shkollën, familjen dhe shoqërinë në përgjithësi.

Varësisht prej natyrës së problemeve me të cilat ballafaqohen në shkollë, psikologu në radhë të parë duhet t'u qaset nxënësve, vetëkuptohet atyre me natyrë jomiqësore, arrogante e të dhunshme, duke synuar që me anën e këshillave të tij, nëpërmjet një komunikimi miqësor, profesional e bindës të arrijë rezultatet e dëshiruara, në radhë të parë në vetëdijësimin e vetë këtyre fëmijëve për dëmet e sjelljeve të tyre. Këto çështje janë mjaft komplekse, kështu që psikologu, së bashku me mësimdhënësit e prindërit duhet të dëshmojnë durim, profesionalizëm

dhe këmbëngulësi, deri në ndikimin e tyre të dukshëm, të çfarëdo shkalle qoftë.

3.4.4. Komunikimi mes shkollës dhe bartësve të aktiviteteve të lira në shkollë motivojnë nxënësit për mësim

Një aspekt i punës së përgjithshme në shkolla janë edhe aktivitetet e lira, të cilat kanë të bëjnë me angazhimin e nxënësve më të dalluar, përkatësisht të atyre me prirje të veçanta në lëmenj të ndryshëm, gjithsesi nën mbikëqyrjen e mësimeve apo të personelit tjetër kompetent në shkolla.

Nga praktika e këtyre aktiviteteve në shkollat tona vërehet se bartësit e këtyre aktiviteteve angazhohen zakonisht para festave të ndryshme, qoftë me karakter shtetëror, qoftë edhe ato me karakter shkollor, por sidoqoftë, edhe për realizimin e këtyre aktiviteteve kulturore a sportive duhet të dëshmohet një kulturë e lartë komunikimi mes subjekteve të përfshira. S'mund të ketë rezultate të dallueshme, nuk mund të shënohen arritje të larta të këtyre aktiviteteve pa një kulturë profesionale, krahas talentit dhe vullnetit të nxënësve për të dëshmuar prirjet e tyre, më cilindo aktivitet qoftë.

Kështu në nivel të shkollave janë të formuara seksione të ndryshme, janë të angazhuar bartësit konkretë dhe janë të përcaktuara datat e manifestimeve të ndryshme në përputhje me karakterin e festave, por që të shënohen rezultate të dukshme dhe të kënaqshme, duhet t'u paraprijë një komunikim jo vetëm profesional, por para së gjithash i kulturuar e motivues. Bile pikërisht motivi për t'i angazhuar nxënësit e talentuar në lëmenj

të ndryshëm është parakushti themelor i arritjeve në realizimin e tyre në nivel të shkollës. Që kjo të arrihet, komunikimi duhet të jetë i gjithanshëm, i koordinuar në mes të shkollës, prindërve dhe eventualisht, në raste të veçanta, edhe me organet kompetente të arsimit në nivel komune a më lart.

IV. REZULTATET E HULUMTIMIT


Pyetjet për mësime të reja

Në punën hulumtuese me anën e disa pyetësorëve dedikuar nxënësve, ashtu edhe mësime të reja kanë dalë përgjigje interesante, të cilat do t'i analizojmë në vijim. Nëpërmjet tyre jam munduar që hulumtimet e bëra në forma të tjera, sipas metodave të lartpërmendura, t'i pasuroj dhe t'i përplotësoj edhe me rezultatet e kësaj ankete, në mënyrë që tërë ky punim të dalë sa më i kompletuar dhe, mbi të gjitha, më i besueshëm në konstatimet e dala.

1. A jeni të trajnuar për zbatimin e teknikave të reja në mësime të reja ?

Kështu, pyetjes së parë parashtruar mësime të reja, 58 për qind e tyre i janë përgjigjur se kanë ndjekur kurse trajnimi për zbatimin e teknikave të reja për mësime të reja, 19 për qind e tyre se nuk kanë vijuar ndonjë kurs trajnimi të kësaj natyre, derisa 23 për qind e tyre se i kanë vijuar vetëm pjesërisht, përkatësisht se kanë njohuri për vetëm disa nga këto teknika, që gjithsesi reflektojnë në rezultatet e mësime të reja.

Pyetja	A jeni të trajnuar për zbatimin e teknikave të reja në mësimdhënie ?		%
Përgjigjja	a) Po	78	58
	b) Jo	25	19
	c) Disa	32	23




Po t'i analizojmë këtë përfundime del se megjithatë numri i mësimdhënësve të cilët i kanë ndjekur trajnimet e nevojshme është solid, derisa përgjigjet e fundit se mësimdhënësit i kanë vijuar vetëm disa nga trajnimet e preferuara (23 %) është jologjike. Pra do të duhej që të kuptohej rëndësia e vijimit të të gjitha trajnimeve, në mënyrë që të arrihen përfitime maksimale nga dobia e tyre.

2. A e shton interesimin për mësim të nxënësit përdorimi i këtyre teknikave, siç janë: stuhi mendimesh, ditari dypjesësh, pesëvargëshi etj?

Edhe pyetjes së dytë i janë dhënë përgjigje të pritura, ngase 74 për qind e mësimdhënësve kanë konfirmuar se çdo teknikë e re ndikon drejtpërdrejt në shtimin e interesimit të nxënësve për mësim, ashtu si edhe për teknikat konkrete. Befasuese ndoshta është përqindja e mësimdhënësve, 16 %, që janë deklaruar se teknikat e reja nuk ndikojnë në shtimin e interesimit të nxënësve për mësim, derisa shifra prej 20 % e mësimdhënësve, të cilët deklarojnë se këto teknika ndikojnë vetëm nganjëherë në rritjen e interesimit të nxënësve për mësim, mund të merret si e pritshme.

Pyetja	A e shton interesimin për mësim të nxënësit përdorimi i këtyre teknikave, siç janë: stuhi mendimesh, ditari dypjesësh, pesëvargëshi etj?		%
Përgjigjja	a) Po	99	74
	b) Jo	21	16
	c) Ndonjëherë	27	20




Nga këto rezultate del se përgjigjet e dhëna janë të logjiksme, përjashtojtë përqindjen e fundit (20 %), të cilët nuk shprehin bindshëm se teknikat e reja gjithsesi avancojnë mësimnxënien dhe rrisin atraktivitetin e procesit mësimor.

3. Çfarë ju pengon për përdorimin e metodologjive bashkëkohore në procesin mësimor?

Përgjigjet e dala nga mësimdhënësit në këtë pyetje janë krejt të pritshme dhe të marra me mend, ngase 59 për qind e tyre kanë deklaruar se numri i madh i nxënësve në klasë është faktori kryesor që pamundëson praktikimin e metodologjive të reja mësimore në klasë, por nuk më është dukur e arsyeshme pse edhe teksti shkollor të jetë pengesë për realizimin e metodave bashkëkohore mësimore me nxënës, derisa mësimdhënësi duhet ta ketë deri diku një pavarësi për t'u shërbyer me tekstin shkollor dhe jo të mbetet domosdoshmërisht vetëm brenda tij. Edhe përqindja e atyre që mendojnë se menaxhimi jo i mirë i klasës ndikon në mospërdorimin e metodave të reja mësimore është e pritshme dhe e arsyeshme.

Pyetja	Çka ju pengon për përdorimin e metodologjive bashkëkohore në procesin mësimor?		%
Përgjigjja	a) Numri i madh i nxënësve në klasë	79	59
	b) Menaxhimi jo i mirë i klasës	25	19
	c) Mungesa e mjeteve mësimore	12	9
	d) Tekstet shkollore të ngarkuara	30	22



4. Si e bëni motivimin e nxënësve për mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive ?

Kësaj pyetjeje mësimdhënësit i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme, secili sipas preferencave personale, por të gjithë vërehet se kanë metodologji të njëjta, po aq sa edhe të ndryshme në qasjen e tyre ndaj procesit mësimor. Kështu shumica e mësimdhënësve janë deklaruar se motivim qendror në punën e tyre është përpjekja e tyre që të jenë sa më atraktive, që qasja të jetë interaktive, por që këtë e pamundësojnë ose e kushtëzojnë edhe natyra e përmbajtjes së njësisë mësimore, ashtu si edhe struktura e nxënësve në një klasë të caktuar. Në këtë pikë, duhet të përmendim se gjatë bisedave të lira pothuajse të gjithë mësimdhënësit e kanë potencuar faktin se jo në të gjitha klasat mund të

aplikohen metoda të njëjta, ato që i konsiderojmë më të suksesshme, sepse kjo është e kushtëzuar nga struktura e nxënësve në klasë të ndryshme, të cilët edhe ndikojnë në procesin e mësimdhënies.

5. Çka mendoni se duhet të ndryshohet në sistemin arsimor?


Ndërsa kësaj pyetjeje mësimdhënësit i janë përgjigjur në mënyrë shumë heterogjene, sepse pikëpamjet kanë qenë shumë të ndryshme. Por, megjithatë, në një pikë sikur të gjitha pikëpamjet e tyre përputheshin: se sistemi arsimor në vend duhet të ndryshojë. Nga ana tjetër, kishte mendime, sado që më të pakta, se reformat e deritashme nuk janë treguar aspak efektive, prandaj do të duheshin reforma të tjera, deri tek ato se sistemi i mëparshëm arsimor ka qenë më i suksesshëm. Kryesisht mendimet e mësimdhënësve kishin të bëjnë me vitet e shkollimit, si dhe me kompetencat e stafit dhe të udhëheqjes së shkollave, ngase zhveshja e tyre nga çdo kompetencë sikur e ka zbehur edhe interesimin për menaxhim të suksesshëm të shkollave. Një prej kërkesave të theksuara ndjeshëm ka qenë që nxënësit problematikë të ndëshkohen nga vetë shkolla dhe në këtë aspekt të mos ndërhyjnë organet jashtëshkollore, sepse kjo po ndikon drejtpërdrejt në mirëvajtjen e procesit mësimor në shkolla.

6. Cilat burime i përdorni për hartimin e planit dhe të programit mësimor?

Përgjigje relativisht jo të pritshme kanë dalë edhe nga kjo pyetje, sepse 48 për qind e të intervistuarve janë shprehur se tekstet shkollore, edhe ato alternative, shërbejnë si burim kryesor për hartimin e planeve dhe të programeve mësimore gjatë një viti shkollor. Derisa do të duhej që planet dhe programet e

Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të shërbenin si bazë themelore për hartimin e planeve mësimore nga mësimdhënësit, nga përgjigjet del se vetëm te 37 për qind e mësimdhënësve ato shërbejnë si burim kryesor, derisa përqindja tjetër është gjithashtu për t'u hulumtuar, sepse sado që mund të bëhen së bashku planet dhe programet, duke bashkëpunuar mes vete mësimdhënësit, që në parim nuk ka asgjë të keqe, sidoqoftë, ato duhet të bazohen në tekstet shkollore ose në planet dhe në programet e institucioneve kompetente.

Pyetja	Cilat burime i përdorni për hartimin e planit dhe programit mësimor?		%
Përgjigjja	a) Tekstet shkollore, alternative	64	48
	b) Planet dhe programet e MASHT-it	50	37
	c) I bëni së bashku me kolegët	21	16



Ndërsa mendojmë se, e kjo ka rezultuar si alternativë e preferuar dhe efikase edhe nga biseda me shumë mësimdhënës, se ata, pra mësimdhënësit, duhet të kenë më shumë pavarësi në hartimin e planeve dhe të programeve mësimore për lëndët përkatëse, duke u shërbyer planet dhe programet institucionale vetëm si modele orientuese. Ngase më shumë se të tjerët, vetë

mësimdhënësit janë ata që e dinë se cilave njësi mësimore duhet dhënë përparësi, apo edhe hapësirë më të gjerë në praktikën mësimore, cila qasje është dëshmuar tashmë si më funksionale dhe ku duhet përqendruar fokusimin profesional, në mënyrë që planit dhe programi mësimor të jetë atraktiv dhe joshës për shumicën e nxënësve në shkollë, e si rrjedhim afron rezultate më të mira në mësimnxënie, si njëri prej synimeve thelbësore të sistemit arsimor në të gjitha nivelet.

7. A shtojnë interesimin për mësim mjetet elektronike informative (kompjuteri etj.), dhe a i ndihmojnë ato nxënësit gjatë të nxënësve ?


Ndërsa përgjigjet e mësimdhënësve rreth kësaj pyetjeje kanë qenë të larmishme, por një gjë, befasisht, ishte dominuese. Pothuajse shumica absolute e mësimdhënësve janë deklaruar se përdorimi i kompjuterëve në klasa me numër kaq të madh nxënësish nuk po tregohet efektiv, sepse duke mos pasur mundësi të përcillen të gjithë nxënësit, shumica prej tyre kompjuterin e përdorin për nevoja të tjera, gjithsesi jashtëmësimore. Derisa rreth përdorimit të mjeteve të tjera elektronike, si videoprojektorëve, për shembull, deklarohen se ato vetëm sa e bëjnë orën mësimore më interesante, sepse duke i demonstruar dijet teorike edhe me pamje vizuale plotësohen njohuritë e tyre për njësi të caktuara mësimore.

8. Çfarë ndikon në rezultatet jo të kënaqshme si në testin e arritshmërisë, ashtu edhe në atë të maturës?

Përgjigjet e kësaj pyetjeje janë të pritshme, sidomos shifra prej 63 për qind e mësimdhënësve, të cilët deklarojnë se mos-

interesimi i nxënësve është faktori kryesor në mosarritjen e rezultateve të kënaqshme në mësimnxënie. Por e papritshme ka qenë përgjigjja prej 31 për qind e mësimdhënësve, të cilët kanë deklaruar se mosrealizimi i planit dhe i programit është faktor që ndikon në mosarritje të rezultateve të kënaqshme nga nxënësit, sepse një planifikim i kujdesshëm i planit dhe i programit mësimor nuk do të duhej të reflektonte me mosrealizim plani gjatë vitit shkollor. Prandaj edhe në këtë pikë duhet një hulumtim i veçantë rreth shkaqeve të mosrealizimit të mundshëm të orëve mësimore gjatë vitit shkollor, për ta përcaktuar se ku qëndrojnë shkaqet objektive të një mosrealizimi të mundshëm të orëve mësimore, në janë ato të natyrës objektive apo subjektive.

Pyetja	Çfarë ndikon në rezultatet jo të kënaqshme si në testin e arritshmërisë, ashtu edhe në atë të maturës?		%
Përgjigjja	a) Mosrealizimi i planit vjetor	41	31
	b) Mosinteresimi i nxënësve për mësim	84	63
	c) Tjetër	8	6




9. Cilët mund të jenë shkaktarët e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim, sipas jush?

Derisa përgjigjet e dala nga kjo pyetje kanë qenë pak më befasuese, por shumë objektive. Ngarkesa e planeve dhe e programeve është trajtuar si një prej pengesave më të qenësishme në humbjen e interesimit të nxënësve për mësim në të gjitha nivelet, edhe jashtë kësaj ankete, nga bisedat e lira në shkollë me subjekte të ndryshme, e kështu kanë dalë edhe nga përgjigjet e kësaj pyetjeje nga mësimdhënësit. 68 për qind e tyre janë deklaruar se pikërisht ngarkesat e tepërta të planeve dhe programeve janë shkas për mosinteresim të mjaftueshëm të nxënësve për mësim, derisa 22 për qind të tyre janë deklaruar se edhe mësimdhënia jocilësore është shkak i humbjes së interesimit të nxënësve për mësim, që gjithashtu është racionale. Ndërsa çuditërisht nuk kishte të tillë që të jepnin përgjigje se edhe shkaqe të tjera janë faktorë të humbjes së interesimit për mësim nga nxënësit.

Prandaj përsëri del më racionale që të jenë vetë mësimdhënësit ata që i përgatisin planet dhe programet mësimore, gjithmonë konform rrethanave aktuale në secilën shkollë, duke i pasur parasysh specifikat dhe faktorët e tjerë që e përshkojnë çdo shkollë në kushtet aktuale. Natyrisht se edhe këtyre planeve dhe programeve duhet bërë një kontroll institucional dhe një vëzhgim profesional, në mënyrë që të mos dalin jashtë parame-trave të përcaktuar nga organet kompetente.

Pyetja	Cilët mund të jenë shkaktarët e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim sipas jush?		%
Përgjigjja	a) Planet dhe programet e ngarkuara	91	68
	b) Mësimdhënia jocilesore	29	22
	c) Mospërdorimi nga ana e disa mësimdhënësve e metodave të reja mësimore	0	0
	d) Numri i madh nxënësve në klasë	0	0
	e) Infrastruktura jo e përshtatshme	0	0

10. Në lëndën tuaj si e bëni vlerësimin e nxënësve ?



Kësaj pyetjeje i janë dhënë përgjigje të ndryshme dhe të shumta, sepse, varësisht prej preferencave të mësimdhënësve, kanë dalë në shesh edhe mënyra të ndryshme të vlerësimit të dijes së nxënësve. Sidoqoftë, dominon mënyra e këtij vlerësimi me ese, duke pasuar ajo me gojë dhe pastaj edhe me teste. Kjo do të thotë se dominojnë mënyrë e vlerësimit të dijeve të nxënësve me shkrim, qofshim nëpërmjet esesë apo edhe testeve të ndryshme të hartuara nga mësimdhënësit.

Pyetja Përgjigja	Në lëndën tuaj si e bëni vlerësimin e nxënësve ?		%
	a) Me gojë	74	
b) Me teste	58	43	
c) Me angazhim gjatë gjithë kohës	45	34	
d) Me ese	110	82	
Të tjera	0	0	



4.1. Opinionet e mësimeve dhe të nxënësve nga punëtorja

Edhe sot e këtë ditë ka diskutime për rolin parësor të prindit, duke dalë në sipërfaqe pikëpamje të ndryshme, vlerësime e gjykime të llojllojshme për vendin që meritojnë prindërit në vendimmarrje në shkollë. Por një gjë nuk ka mundur të kontestohet: roli i teksteve shkollore pa dyshim është i pamohueshëm dhe është burim thelbësor për përvetësimin e njohurive letrare, arsimore dhe përgjithësisht kulturore, si hallkë e domosdoshme për zgjerimin e dijeve edhe në fusha të tjera në sistemin e përgjithshëm arsimor në vend. Duke pasur parasysh se tekstet shkollore, krahas afrimit të njohjeve për fillet e traditës shqiptare

dhe shkencore në planin kombëtar, ai ka edhe vlera të tjera praktike e metodike, duke zhvilluar te nxënësit interesimin për thellimin e njohjeve letrare e kulturore, aftësinë për punë të pavarur, aftësinë e gjykimit dhe vlerësimit kritik si dhe rrjedhimisht edhe zhvillimin e të menduarit sistematik për gjykime abstraksi- oni. Duke pasur parasysh këto vlera të teksteve shkollore, edhe sot e kësaj dite, hartohet sipas kërkesave bashkëkohore metodologjike dhe me përmbajtje kreative që tërheqin vëmendjen e nxënësit për njohurit e përgjithme të përfshira, si një bazë për thellimin e tyre në nivele më të larta arsimore.

Motivimi është një prej faktorëve kryesorë që ndikon në rezultate efektive për mësim dhe në nxitjen e kureshtjes për studimeve novative te nxënësve në bashkëpunim të mësimdhënësve studiues.

Faktorët e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim janë faktorë subjektivë, objektivë dhe të përgjithshëm, si mernaxhimi jo i mirë i shkollës, mjedisi i papërshtatshëm, problemet familjare, shqetësimet për gjendjen ekonomike – familjare, mungesa e teksteve shkollore etj.

Në shoqërinë bashkëkohore interesimin për mësim dhe për një sukses të kënaqshëm e shton edhe profesionalizmi i mësimdhënësve. Nëse disponimi i mësimdhënësit nuk është i pranishtëm, atëherë te nxënësit paraqitet mosinteresim i plotë për mësim.

Në këtë punëtori gjatë diskutimit nga mësimdhënësit kërkohet që të krijohen kushtet e përshtatshme për mësimdhënie, të kenë bashkëpunim dhe përkrahje si nga ana institucionale dhe ajo familjare.

Nëse familja përbëhet nga prindër me arsim të ulët, braktisja e shkollës është më e theksuar, kanë interesim të ulët për arsimimin fëmijëve, atëherë fëmijët bien pre e pakujdesisë së prindërve.

Roli i psikologut është mjaft i madh duke ndihmuar në vetëdijesimin e ngritjes së kureshtjes për mësimnxënie dhe mosbraktisjes së institucioneve shkollore, duke organizuar takime të ndryshme për motivimin e zgjuarjes së kureshtjes për mësim.

Humbjen e interesimit të nxënësve për mësimet e shkaktajnë:

- Infrastruktura, (jo e përshtatshme e mjedisit në shkollë;
- Mbingarkesa e planeve dhe e programeve mësimore;
- Familja (niveli i ulët i edukimit në familja);
- Sjellja jokorrekte e mësimitdhënësve në shkollë;
- Vullneti i kundërshtimit të nxënësve nga padrejtësia;
- Mospërgatitja e mësimitdhënësve ndikon në zvogëlimin kureshtjes së nxënësve;
- Puna në grupe, në aktivitete të ndryshme dhe bashkëpunimi me prindër dhe nxënës;
- Gjendja sociale dhe ekonomike në familje, papërgjegjësia e prindërve;
- Roli i pedagogut – psikologut, ka rëndësi të madhe në ngritjen e interesimit të nxënësve për mësim, sidomos kur sot mungon ora e kujdestarisë dhe është numri i madh i nxënësve në klasë.

Përpos faktorëve të përmendur, në braktisjen e shkollës nga nxënësit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, si:

Dekurajimi i fëmijëve nga të rriturit, tek nxënësit ndikon shumë për mos sukses edhe rrethi shoqëror (shoqet dhe shokët).

Dallimet në strukturën e fëmijëve, mungesa e kabineteve dhe mjediseve të tjera punuese, prindërit e paarsimuar, kultura e komunikimit të mësimdhënësve, qasja e tyre ndaj nxënësve aftësia e tyre në zgjidhjen e problemeve të nxënësve, Numri i madh nxënësve në klasë që është një shkak në vete për humbjen e interesimit të nxënësve për mësim dhe zhgënjimi i nxënësve në vlerësim janë shkaqe për humbjen e interesimit të nxënësve për mësim.

Rënia e interesimit për mësim e shkaktojnë;

- ❖ Numri i vogël i disa orëve në lëndët e caktuara;
- ❖ Shpjegimi i stërzgjatur i mësimdhënësve;
- ❖ Ndryshimi i metodave të mësimdhënies herë pas here;
- ❖ Mësimdhënës të papërgatitur mirë profesionalisht;
- ❖ Paaftësia e mësimdhënësve në interpretim.

Po ashtu edhe prania e pedagogut-psikologut në shkollë është më se nevojshme. Ndhima e tyre ndikon shumë ngritjen morale dhe intelektuale të nxënësit. Rritja e vetëbesimit të nxënësit është faktor i rëndësishëm në rritjen e tyre.

Zgjedhja e problemeve emocionale të nxënësve në mënyrë që shkolla të jetë qendër atraktive e dijes .

Shkolla, hapësira e pamjaftueshme shkollore, mungesa e mjeteve të konkretizimit.

Mësimdhënësi, përgatitja joprofesionale, neglizhenca në punë, gjendja e rëndë ekonomike (paga), familja, jointeresimi i

saj, mungesa komunikimit në shkollë, mungesa e trekëndëshit didaktik, ngarkesa e tepërt me tekste shkollore, gabimet e shumta, plani dhe programi i ngarkuar, mosharmonizimi i shtëpive botuese ndërmjet tyre.

Prindërit janë ata të cilët duhet të menaxhojnë kohën e fëmijëve të tyre, ku roli i pedagogut ka karakter ndihmës, këshillues. Sado që mësimdhënësi e njëh psikologjinë e fëmijëve, problemet e tilla drejt i trajton vetëm psikologu.

Pasurimi i bibliotekave me literaturë të gjuhëve të huaja që është domosdoshmërie e kohës në formimin kulturor dhe krijues tek nxënësit dhe ngjallje të kureshtjes për mësim.

Sipas ligjit, çdo institucion shkollor është i obliguar t'i ketë organet e parapara, të cilat ndihmojnë në planifikimin e veprimtarisë shkollore dhe mbështesin arritjet e pikësnyimeve të përgjithshme të institucionit përkatës. Me këtë është paraparë t'u jepet mundësia të gjitha strukturave, si mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe kategorive të tjera që të kenë një rol më aktiv në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe mbarëvajtjes së përgjithshme të punëve në shkolla. Kërkimet kanë treguar se ka një ndërlidhje të ngushtë në përfshirjen e këtyre strukturave në edukimin dhe përparimin arsimor të nxënësve në shkolla dhe bile është vlerësim i përgjithshëm se me një koordinim të aktiviteteve dhe me një bashkëpunim planifikues të të gjitha subjekteve krijohen mundësi për arritje më të larta dhe për proces mësimor më cilësor dhe më të angazhuar në bazë të këtyre rrethanave edhe interesi i nxënësve për mësim do të shtohet dhe suksesi nuk do të mungojë.

Duke e parë anën funksionale të ekzistimit të këtyre organeve të shkollave në ofrimin e mbështetjes së gjithanshme për edukimin dhe arsimimin sa më të mirë të nxënësve, çka nënkuptohet se interesi i nxënësve duhet të jetë gjithmonë në plan të parë, roli i tyre, ndër të tjera, mund të fokusohet në këto veprimtari:

- të realizohet një udhëheqje profesionale, efikase, korrekte dhe e koordinuar, si garanci për performancë të mirë të punëve në institucion;
- të ofrohet konsulencë e gjithanshme në mes të drejtorit dhe organeve të tjera të shkollës, si në aspektin organizativ, ashtu edhe në atë profesional;
- të mobilizohen dhe të inkurajohen të gjitha strukturat e mundshme të rrethit në përfshirjen e dhënies së kontributit të tyre për mbarëvajtjen e punëve në shkollë;
- të ndërtohen marrëdhënie efektive në mes të shkollës, prindërve dhe nxënësve;
- t'u mundësojnë prindërve dhe të gjitha strukturave që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për edukimin publik.

Pra, nga sa shihet, organet e shkollës kanë rol shumë domethënës në mbarëvajtjen e përgjithshme të punëve në shkollë, të cilët gjithmonë në koordinim dhe me bashkërendim të ndërsjellë ndihmojnë në planifikimin e aktiviteteve të gjithanshme në shkollë dhe të aktiviteteve jashtëshkollore, në përpilimin e kalendarit të aktiviteteve shkollore, mënyrat e pranueshme të sjelljes në mjediset shkollore, gjithmonë në përputhje me standardet bashkëkohore, ashtu si edhe politikat konfliktzgjidhëse, vendosjen e prioriteteve në programin e shkollës, mënyrat për vendosjen e një komunikimi sa më efektiv shkollë-prind-nxënës, krite-

rin kryesor përzgjedhës, deri te përdorimi i mjediseve të shkollës nga komunitetet apo edhe në ndikimin e tyre në profilin e shkollës.

Çdo institucion arsimor, ashtu si edhe i çdo karakteri tjetër, është i obliguar me ligj që të ketë organet udhëheqëse, në krye të së cilave qëndron drejtori. Ai është person që përfaqëson institucionin në raport me organet e tjera më të larta shtetërore kompetente, ndaj të cilave mban përgjegjësi dhe jep llogari-dhënie. Pra drejtori merr instruksionet nga organet kompetente dhe i përcjell në institucionin që e udhëheq, duke qenë koordinator i dyanshëm: në mes të institucioneve kompetente shtetërore dhe kolektivit të institucionit përkatës, në krye të të cilit qëndron. Në mënyrë përmbledhëse mund të konstatojmë se drejtori organizon, planifikon dhe udhëheq në tërësi punën e shkollës, në të gjitha segmentet e saj. Roli i tij në këtë kontekst është i pazëvendësueshëm, por kjo nënkupton se edhe zgjedhja e tij duhet t'i nënshtrohet një filtri të rreptë profesional, shoqëror dhe etik.

Nga sa u tha dhe ashtu siç mund të dalë nga obligimet e përcaktuara me ligj, drejtori kryen këto detyra dhe obligime ndaj institucionit:

- përfaqëson shkollën dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së saj,
- i udhëheq dhe i koordinon të gjitha aktivitetet në shkollë,
- përgatit propozimin e planit vjetor të punës dhe është përgjegjës për jetësimin e tij,
- udhëheq punën e këshillit pedagogjik,
- përgatit mbledhjet e këshillit drejtues,
- i raporton këshilli drejtues për punën e shkollës,
- mbikëqyr dhe këshillon personelin e shkollës,

- kujdeset për bashkëpunimin e institucionit me prindërit (mbledhjet e prindërve, orët për biseda dhe format e tjera të bashkëpunimit),
- njofton prindërit për punën e shkollës, si dhe për ndryshimin e të drejtave dhe të obligimeve të nxënësve,
- vendos për masat edukative,
- është përgjegjës për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave dhe detyrimeve të nxënësve,
- përcakton sistematizimin e vendeve të punës,
- vendos për krijimin e marrëdhënies së punës dhe për përgjegjësinë disiplinore të punëtorëve,
- kujdeset për bashkëpunimin e shkollës me shërbimin shëndetësor të saj dhe
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin dhe në bazë të autorizimeve të këshillit drejtues.

Pyetjet për nxënës


Pyetje të përcaktuara për këtë hulumtim u janë parashtruar edhe nxënësve, në mënyrë që edhe nga ta të nxirren pikëpamje, mendime dhe ide për aspekte të caktuara që lidhen me mësim-nxënien dhe shkollën në përgjithësi. Fokusi ka qenë i përqendruar në momentet të cilat, sipas mendimit tonë, paraqesin pikat më të rëndësishme që ndikojnë në suksesin e arritjeve mësimore, siç janë raportet nxënës-mësimdhënës, si dhe aspekte të tjera të punës dhe të angazhimit të mësimdhënësve në procesin mësimor dhe në aktivitete të tjera shkollore.

T'i shohim rezultatet e dala nga hulumtim:

1. A është mjedisi në shkollë i përshtatshëm për nxënës?

Kështu nga pyetja e parë rezultatet e përgjigjeve nga nxënësit kanë dalë atë të balancuara, sa është për t'u marrë në shqyrtim seriozisht nga organet kompetente për ta ndryshuar këtë aspekt, që pa dyshim ka rëndësi thelbësore edhe në rezultatet e mësimnxënies. Pra shifra prej 44 për qind e nxënësve, të cilët janë deklaruar se mjedisi i tyre shkollor nuk është i përshtatshëm për mësim, është shqetësuese dhe njëkohësisht paralajmëruese për organet kompetente që të bëjnë edhe më shumë në përmirësimin e kushteve nëpër objektet shkollore.


Pyetja	A është mjedisi në shkollë i përshtatshëm për nxënësit ?		%
Përgjigjja	a) Po	115	55
	b) Jo	93	44



2. A jeni të kënaqur si zhvillohet mësimi në shkollën tuaj ?

Ndërsa po ta kemi parasysh klimën e përgjithshme të shkollës sonë aktualisht, edhe përgjigjet e nxënësve të kësaj pyetjeje janë deri diku të pritshme. Prandaj kur 54 për qind e tyre shprehen se janë vetëm deri diku të kënaqur me zhvillimin e procesit mësimor në shkollën e tyre, kjo reflekton sa një situatë normale në rrethanat aktuale, aq një shqetësim pse është kjo gjendje e tillë, e cila mund të klasifikohet si e papranueshme. Që këtej, pa humbur kohë organet tona arsimore duhet të shtojnë kontrollin institucional nëpër shkolla dhe të angazhojnë ekipe profesionale për t'i hulumtuar shkaqet objektive të një gjendjeje të tillë, në mënyrë që zhvillimi i procesit mësimor të bëhet në përputhje të plotë me të gjithë parametrat e paraparë.


Pyetja Përgjigjja	A jeni të kënaqur si zhvillohet mësimi në shkollën tuaj ?		%
	a) Te kënaqur	96	46
	b) Deri diku të kënaqur	114	54



3. A janë arsimtarët ata që jua shtojnë interesimin për mësim ?

Përgjigjet e dala nga kjo pyetje gjithashtu mund të merren si shqetësuese, sepse përqindja më e madhe e nxënësve kanë deklaruar se mësimdhënësit nuk janë ata që ua shtojnë interesimin për mësim, me çka mund të nënkuptohet, sado që nuk është domosdoshmërisht kështu, se ata nuk janë në nivelin e duhur gjatë orëve mësimore. Prandaj, po ta marrim këtë përgjigje si barometër të angazhimit të mësimdhënësve në shkollë, del e nevojshme që në radhë të parë organet drejtuese të shkollës të marrin masat e nevojshme, në mënyrë që t'u tërhiqet vërejtja mësimdhënësve të caktuar që t'i shtojnë përpjekjet dhe angazhimin e tyre gjatë procesit mësimor. Por jo më pak e rëndësishme del nevoja e vetëdijesimit të vetë mësimdhënësve për t'u ndërgjegjësuar për shtimin e nivelit të angazhimit profesional dhe përdorimit të metodave bashkëkohore dhe atraktive në orët mësimore.


Pyetja Përgjigja	A janë arsimtarët ata që ua shtojnë interesimin tuaj për mësim?		%
	a) Po		67
b) Jo		102	49
c) Ndonjëherë		41	20



4. Si është dialogu juaj me mësime dhënësit ?

Edhe përgjigjet në këtë pyetje janë për t'u shqetësuar, sepse megjithatë del se një numër i shumtë i nxënësve nuk kanë marrëdhënie të qëndrueshme, të duhur dhe në nivel me mësime dhënësit. Kjo ngase ata që janë mesatarisht të kënaqur dhe të pakënaqurit janë shumicë, kështu që organet drejtuese të shkollës duhet marrë me këtë problematikë, sidomos me mësime dhënësit të caktuar, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt edhe në rezultatet e mësime nxënies. Ndërsa organet kompetente arsimore të niveleve të tjera duhet t'i hulumtojnë këto shkaqe dhe sado pak të ndikojnë në eliminimin e tyre, në mënyrë që të vendoset një dialog i qëndrueshëm mes mësime dhënësitve dhe nxënësve, ai parakusht për rezultate më të mira në mësime nxënies.


Pyetja	Si është dialogu juaj me mësime dhënësit ?		%
Përgjigja	a) I kënaqshëm	96	46
	b) Mesatarisht i kënaqshëm	44	21
	c) Jo i kënaqshëm	71	34



5. Çka e bën motivuese një orë mësimore?

Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur aq sa sipas pritjeve, për alternativën e parë, po aq befasuese për alternativën e dytë, nga se më parë se teksti shkollor, mënyra e mësimdhënies, atraktiviteti, profesionalizmi dhe ndjeshmëria e mësimdhënësit do të duhej të ishin më parë si motive për ta nxitur kureshtjen e nxënësve për mësim, e si rrjedhojë tek pastaj të vijë teksti si mjet referues i një njësie mësimore nga nxënësit. Këtë konstatim e mbështes ngase në bisedat e lira më nxënës, gati pa përjashtim secili prej tyre e thekson se është mësimdhënësi dhe mënyra se si ai e ligjëron lëndën, sa e bën atraktive dhe të kapshme për ta një njësi mësimore faktori kryesor që ndikon në motivimin e tyre për mësim, menjëherë pas përmbajtjes mësimore. Andaj përsëri që këtej del nevoja që në bazë të përvojës së tyre mësimdhënësit t'i përzgjedhin njësitë mësimore, duke u mbështetur pikërisht te motivimi i tyre për mësimnxënie më të lehtë nga nxënësit, natyrisht duke u mbështetur gjithherë në kritere të qëndrueshme dhe të arsyeshme gnostike dhe të tjera.

Pyetja	Çka e bën motivuese një orë mësimore?		%
Përgjigjja	a) Përmbajtja e mësimit	101	48
	b) Teksti shkollor	66	31
	c) Mënyra e mësimitdhënës	42	20
	d) Të tjera (nënvizo një e më shumë)	0	0




6. Në shkollën tuaj a realizoni vizita brenda vitit, të cilat kanë karakter edukativ, njohës e arsimor (si muze, vende historike etj.)?

Edhe kësaj pyetjeje nxënësit i janë përgjigjur negativisht në një përqindje më të madhe sesa është pritur, sepse del që megjithatë ka shkolla të cilat nuk i realizojnë këto vizita, ose që nxënësit i kanë neglizhuar përgjigjet e tyre. Mirëpo, sidoqoftë, po t'i kemi parasysh edhe përgjigjet e atyre që janë shprehur se vetëm ndonjëherë realizojnë vizita të tilla, mendoj së është shqetësuese, sepse pa dyshim se vizitat e tilla me karakter njohës do të duhej të bëheshin praktika të zakonshme në të gjitha shkollat

në nivelet përkatëse. Derisa nga biseda e lirë me nxënës fitova përshtypjen se ka mendime se sidomos vizitat, pra ekskursionet në vitin e fundit shkollor sikur kanë marrë karakter argëtues dhe komercial dhe shumë pak shfrytëzohen për qëllime njohëse. Sidoqoftë kjo është temë që meriton trajtim dhe qasje tjetër dhe shumë serioze.


Pyetja	Në shkollës tuaj a realizoni vizita brenda vitit, të cilat kanë karakter edukativ, arsimor (si muze, vende historike, etj.)?		
Përgjigjja	a) Po	113	54
	b) Jo	61	29
	c) Ndonjëherë	36	17



7. A përdorin mësimdhënësit teknika të reja gjatë orës mësimore (siç janë stuhi mendimesh, ditari dy pjesësh, pesëvargëshi etj.) ?

Përgjigjet dhënë kësaj pyetjeje nuk janë befasuese, sepse nënkuptohet që nxënësit nuk i njohin teknikat e reja mësimore, por sidoqoftë ata i kuptojnë teknikat e reja dhe mënyrën e shpjegimit të një njësie në klasë nga mësimdhënësit. Dhe pikërisht ky fakt ka qenë qëllimi i shtruarjes së kësaj pyetjeje edhe për nxënës, në mënyrë që të zbulohet se a u bënë përshtypje realizimi i një mënyre të re shpjegimi nga mësimdhënësit, e cila sado kudo do të ndikonte në suksesin e përgjithshëm të mësimnxënies.


Pyetja	A përdorin mësimdhënësit teknika të reja gjatë orës mësimore (siç janë stuhi mendimesh, ditari dy pjesësh, pesëvargëshi etj.)?		%
Përgjigjja	a) Po	61	29
	b) Jo	145	69



8. A përdor mësimdhënësi mjete konkretizimi?

Duke e ditur faktin se mospërdorimi i mjeteve konkretizuese në shkolla, qoftë për arsye edhe objektive, ndikon në motivimin e pamjaftueshëm të nxënësve për mësim, u përcaktova që t'ua shtroj edhe këtë pyetje nxënësve, prandaj edhe përgjigjet janë krejt të pritshme. Mirëpo është shqetësuese përqindja aq e lartë, ngase 70 për qind e tyre të deklarohen se mësimdhënësit nuk përdorin kurrfarë mjeteve mësimore, duhet të shërbejë si argument i mjaftueshëm që të alarmohen organet kompetente arsimore të të gjitha niveleve, por edhe organet e vetë shkollave që kjo praktikë të ndryshojë rrënjësisht. Prandaj duhet gjithsesi të gjenden mënyra që të sigurohen mjete konkretizuese për shkolla dhe për të gjitha lëndët mësimore, që pastaj të ndikohet si në motivimin e nxënësve për mësim, ashtu edhe në rritjen e shkallës së mësimnxënies, si një prej objektivave kryesorë të sistemit tonë arsimor.


Pyetja	A përdor mësime të njohura të mësimit konkretizimi ?		%
	Përgjigjja	a) Po	34
b) Jo		147	70
c) Ndonjëherë		29	14



9. Çka ju bën të ndiheni mirë në mësim?

Kësaj pyetjeje nxënësit i janë përgjigjur relativisht sipas pritjeve dhe në përputhje me rolin dhe perspektivën e tyre në jetë, ngase shkolla dhe mësimi janë rrugët e vetme, gjithsesi më të dinjitetshme në formimin e tyre si personalitete me prestigj dhe të ditur e të vlefshëm në shoqëri. Nuk kishte ndonjë përgjigje të veçantë veç atyre se edhe personaliteti i mësimit dhe i stafit tjetër në shkollë ndikon që ata të ndihen më komodë ose jo.

Pyetja	Çka ju bën të ndiheni mirë në mësim?		%
Përgjigjja	a) Mësoni shumëçka për të ardhmen tuaj	108	51
	b) Ju ndihmon në të shprehur dhe në krijim të imazhit më të mirë për jetën	59	28
	c) Përfitoni njohuri të përgjithshme	47	22
	d) Të tjera	10	5



10. Në cilat forma të vlerësimit nxënësit e ndiejnë veten më atraktive?

Nga kjo pyetje ka dalë një e dhënë interesante, kur shumica e nxënësve janë përgjigjur se ndihen mirë dhe atraktive kur kanë angazhim në klasë, përkatësisht kur mësimdhënësit i angazhojnë rreth temave të ndryshme dhe i mbajnë nxënësit të përqendruar rreth mësimin. Kjo e dhënë dëshmon se me mësimdhënie atraktive edhe nxënësit ndihen mirë dhe të relaksuar, duke mos ndier lodhje dhe monotoni, për më shumë duke pasur vullnet për mësim. E papritshme del përgjigjja tepër e ulët e atyre nxënësve të cilët nuk ndihen mirë në shkrimin e eseve, por sidoqoftë edhe kjo ka refleksionet e veta, sepse jo secili nxënës preferon format e angazhimit me shkrim.

Pyetja Përgjigja	Në cilat forma të vlerësimit nxënësit e ndiejnë veten më atraktivë?		%
	a) Vlerësimi nëpërmes të aktiviteteve	41	20
	a) Me gojë	25	12
	b) Me shkrimin e eseve	17	8
	c) Me angazhim në klasë	109	52



V. KONKLuzionet dhe Rekomnadamimet

5.1. Konkluzionet

Duke e pasur parasysh rëndësinë thelbësore të një komunikimi të kulturuar, profesional dhe njerëzisht të pranueshëm, si një prej kërkesave për një profilizim të shkollës bashkëkohore, si një parakusht për rezultate të larta në mësimnxënie, mësimdhënie dhe në performancën e përgjithshme të shkollës, atëherë para organeve udhëheqëse të shkollave shtrohen detyra që t'i kushtojnë rëndësinë e duhur këtij aspekti në shkollë. Kjo ngase pa një kulturë të mirëfilltë të komunikimit mes subjekteve drejtuese të shkollës dhe të gjithë faktorëve të tjerë që janë të ndërlidhur me shkollën nuk mund të pritet funksionim normal dhe menaxhim i mirë e i suksesshëm i shkollës.

Së këndejmi mund të përfundojmë se për krijimin e një klime të përgjithshme sa më të mirë dhe më të përshtatshme për punë të suksesshme në shkollë të gjithë faktorët duhet të kenë qasje konstruktive ndaj partnerëve bashkëpunues, duke komunikuar me ta mbi bazën e profesionalizmit dhe të interesave të gjithanshme, si në kryerjen e punëve të zakonshme në shkollë, ashtu edhe në vendimmarrje. Prandaj edhe në të ardhmen mbetet kërkesë e domosdoshme që:

- të identifikohet rëndësia e planifikimit si segmenti më relevant, madje strategjik, i fushave të cilësisë së punës në shkolla;

- nga kjo të dalë vizioni i shkollës, objektivat si dhe harmonizimi i afateve dhe i bartësve për realizimin e detyrave të përcaktuara;

- që shkolla të bazojë filozofinë e saj në gjithëpërfshirjen e faktorëve relevantë që ndikojnë në statusin dhe profilin e një shkolle të suksesshme e moderne;

- të inkurajohen shkollat për të përmirësuar nivelin e brendshëm dhe të jashtëm të komunikimit;

- të përkrahen aktivitetet e institucioneve profesionale në nivele të ndryshme për hartimin e doracakëve dhe të udhëzuesve që ndihmojnë këtë proces;

- të angazhohen shkollat në mënyra të ndryshme, qoftë edhe nëpërmes ligjëratave, kurseve a aktiviteteve të tjera për vetëdijesimin e të gjithë faktorëve në shkollë për rëndësinë thelbësore të një komunikimi efektiv, të shkathtë dhe të kulturuar.

5. 2. Rekomandimet

Nga sa u tha deri tash në këtë hulumtim, si dhe duke i pasur parasysh edhe shumë shkaqe të natyrave të tjera, të cilat nuk janë përmendur me këtë rast, por të cilat mund t'i marrim me mend nga përvoja e drejtpërdrejtë në praktikën tonë shkollorë, mund të nxjerrim disa përfundime, të cilat mëtojnë të ndikojnë në përmirësimin e rrethanave të përgjithshme në sistemin tonë arsimor në nivelin fillor dhe të mesëm. Sado që roli i shkollës në formimin e fëmijëve dhe të rinjve mbetet i rëndësishëm primare, megjithatë mbetet e padiskutueshme edhe rëndësia e familjes, përkatësisht gjendja e saj, funksionimi normal i saj, pa mosmarrëveshje a thyerje të rënda, ngase kjo reflekton drejtpërdrejt në natyrën psikike të fëmijëve, rrjedhimisht edhe në suksesin e përgjithshëm në shkollë, ose edhe në orientimin e tyre devijues në shoqëri, me pasoja të rënda për të gjithë.

Kështu që duke i pasur parasysh këto fakte, si dhe shkaqet tërësore objektive a subjektive që ndikojnë në mosinteresimin e duhur a të mjaftueshëm të nxënësve për mësim, të përmendura më lart, rekomandojmë me sa vijon:

- shkolla të pranojë kuadro jo vetëm të kualifikuar, por gjithsesi të përgatitur maksimalisht dhe të gatshëm që të përballen me sfidat e përgjithshme në punën me nxënës;
- nxënësi në asnjë mënyrë nuk duhet ta ndiejë mjedisin e shkollës si "poligon ushtarak", me rregulla dhe tepërta dhe kërkesa që ata i përjetojnë si cenim të lirisë së tyre;
- planet dhe programet mësimore duhet të reformohen edhe më tej dhe t'u përshtaten kushteve të shkollës bash-

- këkohore, duke u kushtuar rëndësi punëve praktike dhe angazhimeve të tjera në mjediset shkollore;
- urgjentisht shkollat duhet të pajisen me mjete shkollore konkretizuese, në mënyrë që ora mësimore të bëhet sa më atraktive;
 - me shumë prioritet institucionet kompetente dhe organet drejtuese të shkollave duhet të angazhohen për ndërrimin e dukshëm dhe të menjëhershëm të mjedisve rreth shkollës, duke instaluar një kulturë të re mjedisi;
 - psikologët në shkolla të merren me shumë seriozitet me rastet e nxënësve ekscesivë, në bashkëpunim me familjen dhe organet drejtuese të shkollës;
 - prindërit duhet të përfshihen shumë më aktivisht në ndjekjen e suksesit dhe të sjelljeve të fëmijëve të tyre në shkollë dhe jashtë saj.

Falënderim

Falënderoj shkollat, nxënësit dhe mësimsdhënësit që kanë marrë pjesë në hulumtim dhe pjesë në punëtori.

Falënderoj edhe hulumtueset e jashtëm për gatishmërinë dhe ndihmën e dhënë gjatë hulumtimit nëpër disa komuna të Kosovës.

Referencat:

Fullan Majkëll „Forca e ndryshimit”, Depërtim në thellësinë e reformës arsimore, Tiranë,2002, (përktheu nga anglishtja: Majlinda Nishku).

Mille Bonnie: “Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit”, Prishtinë 2003.

MASHT: “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë”, Prishtinë 2007.

Miller Bonnie: “Komunikimi me fëmijë”, Prishtinë 2004

MASHT: “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë”, Prishtinë 2007.

Pupovci D, Tafarshiku N.: “Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë”, KEC, Prishtinë 2008.

-Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit: “Hulumtimet në shkencat e edukimit”, Prishtinë, 2010.

Grup autorësh: “Arsimi bazik cilësor”, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë 2006.

-Grup autorësh: “Kërkime Pedagogjike” (Përmbledhje punimesh), Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë 2010.

Shatri Bajram, Arsimi shqip në Kosovë (1990-1999), Prishtinë, 2010.

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, botuar nga MASHT, Prishtinë, gusht 2011.

Manual në ndihmë të psikologut në shkollë”, Tiranë 2006, fq. 36

Rot Nikolla: “Psikologjia e përgjithshme”, Prishtinë 1978, fq. 222.

Woolfolk Anita: “Psikologji edukimi”, Tiranë 2011, fq. 10.

Fullan M.: “Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim”, Tiranë 2001.

Fullam M.: “Forca e ndryshimit”, Tiranë 1999.

Garo S.:”Mësimdhënia bashkëkohore: Tiranë 2008.

Grup autorësh: “Arsimi bazik cilësor”, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë 2006.

Grup autorësh: “Kërkime Pedagogjike” (Përmbledhje punimesh) II, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë 2010.

Hyseni H. Mita N. Salihu J. Pupovci D.: “Qeverisja dhe udhëheqja në arsim”, Prishtinë 2003.

Instituti i Studimeve Pedagogjike: “Hartimi dhe vlerësimi i lehtësisë shkollore”, Tiranë 2003.

Krasniqi I. “Mendimi metodik dhe praktika e mësimit të gjuhës shqipe”, Prishtinë 2004.

KEC: “Strukturë për zhvillimin e mendimit kritik gjatë kurrikulit”, Prishtinë 2005.

Koliqi, H.: “Sistemi i arsimit në Kosovë”, “Libri shkollor”, Prishtinë 2004.

Kuvendi i Kosovës: “Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë”, nr. 2002/2 Prishtinë 2002.

Kuvendi i Kosovës: “Ligji për Inspektimin e Arsimit në Kosovë”, nr. 2004/37, Prishtinë 2004.

Musaj B.: “Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies”, Tiranë 1998.

MASHT: “Korniza e Kurrikulës e arsimit parauniversitar të republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2011.

MASHT: “Standarde për tekstet shkollore”, Prishtinë, 2011.

MASHT: “Plani dhe programi mësimor,8,9, 10,11 ”, Prishtinë, 2003.

MASHT: ”Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007 - 2017”, Prishtinë 2007.

Potera I.: “Libër për edukimin mjedisor për nxënësit e shkollës fillore”, Prishtinë 2002.

Ramaj A.: “Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor”, Prishtinë 2001.

Zuna A. Deva: “Partneriteti shkollë–familje–komunitet”, Prishtinë 2009

Materiale nga interneti:

portali albanologjik Shqipëri - Kosovë. Shfletuar më:
15.04.2014, Grup autorësh.

www.see-educoop.net/...in/.../reforma_kurikuluma-cro-hrv-t.

<http://pedagogjia.ëordpress.com/didaktike/pershtatja-e-te-mesuarit-moshes-se-nxenesve-parim-i-rendesishem-i-mesimdhenies-dhe-te-nxenit/.shfletuar>, Edukimi i te Drejtes per Qytetari ne Kurrikul: Veshtrim Nderkombetar-David Kerr

*Fondacioni Kombetar per Kerkime Arsimore më:
Shfjetuar: 18.04.2013*

<http://www.ef.uni-lj.si> (shkarkuar më 26 qershor 2011).

<http://www.doba.si> (shkarkuar më 26 qershor 2011).

<http://www.cdcd.uni-mb.si>(shkarkuarmë,26qershor2011).

<http://www.open.ac.uk> (shkarkuar më 25 qershor 2011).

<http://www.fernuni-hagen.de> (shkarkuar më 25 qershor 2011)

http://www.londoninternational.ac.uk/about_us/facts.shtm
(shkarkuar më 27 prill 2011).

<http://www.mash.gov.al/matura>.Shkarkuar më: 14.03.2013

<http://www.drzavnamatura.skole.hr>.Shkarkuar: 12.09. 2013

<http://www.invalsi.it>, shfletuar më:15.06.2014

<http://www.matura.gov.mk>. Shkarkuar më. 20.06.2013-MASHT

<http://www.mash.gov.al/faqe.php?id13>.

Journal of Curriculum and Pedagogy,
<http://www.curriculumandpedagogy.org/index.html>, Revistë e
shfletuar më: 17.03.2014

<http://data.planetar.edu.al/files/tekstet%20shkollore909.pdf>,
Shkarkuar më: 23.07.2013, autorë: Prof. Erleta MATO, Msc.
Kozeta NOTI

<http://pedagogjia.wprdress.com>, Faqe e hapur më: 11.04.2013, grup
autorësh.

[http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Strategjia_per_zh
villimin_e_arsimit_parauniversitar_ne_Kosove](http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Strategjia_per_zh_villimin_e_arsimit_parauniversitar_ne_Kosove), shfletuar më:
08.05.2012.

-[http://pedagogjia.wordpress.com/didaktike/pershtatja-e-te-
mesuarit-moshes-se-nxenesve-parim-i-rendesishem-i-
mesimdhenies-dhe-te-nxenit/](http://pedagogjia.wordpress.com/didaktike/pershtatja-e-te-mesuarit-moshes-se-nxenesve-parim-i-rendesishem-i-mesimdhenies-dhe-te-nxenit/), shfletuar më: 02.02.2013.

Abstract

While education for the society is the most important segment of any country, it remains a permanent task of the competent institutions to enhance research about various phenomena that accompany the education system in the country. In this context, ongoing research aims to identify the main causes and effects and weight the losses of the students in the interest of learning, in order to influence positive changes in that direction. So, from observations, conversations and various surveys conducted in several schools in the country have been done. Among other things, it can cause a function within the subjective nature, which may be the result of objective constraints, such extracurricular, which are conditioned by circumstances or by various reasons, other levels, and political or social, but beyond the influence function within. While the proliferation of the Internet and the size of its uncontrolled use by young people, especially students, has become a concern in it, it's very serious, and it should be treated more seriously than hitherto institutionally, so that at least the consequences of this to be as low or reduced.

Keywords: causes, difficulties, no correction, perspective, the Internet.

Botues: Instituti Pedagogjik i Kosovës

Recensentë:

Prof. asoc. dr. Naser Zabeli

Prof. dr. Demë Hoti

Kryeredaktor:

M.Sc. Ismet Potera

Hulumtuese: M.Sc. Safete Statovci-Shala dhe ekipi i IPK-

Hulumtues të jashtëm:

Prof. Violeta Pirraku-Bajraktari

Mr. Nazyktere Hasani

Lektor:

Arif Demolli

Realizimi kompjuterik:

Skender Mekolli

Ballina:

Benart Shala

Shtypi
Shtypshkronja, *Blendi*

Tirazhi. 500 copë

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.04(496.51)(048)

Statovci - Shala, Safete

Shkaqet e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim :
raport hulumtimi / Safete Statovci - Shala. – Prishtinë :
Instituti i Pedagogjik i Kosovës, 2014. – 82 f. : ilustr. me
ngjyra ; 22 cm.

ISBN 978-9951-591-20-1